

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7861 E mërkurë 24 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Edi Rama dhe zëdhënësi i tij më i zellshëm diplomatik, shefi i OSBE-së, kanë folur sot lidhur me mundësinë e ndryshimit të datës së zgjedhjeve. Kryeministri ...
Vijon në faqen 20

Nga ANDI BUSHATI
Rama ka të drejtë, zgjedhjet nuk duhet të shtyhen


Opinion *i* **Ditës**
Aktori komik ukrainas, Volodi-Amir Zelinski, i cili për katër vjet kishte luajtur me sukses rolin e presidentit në serialin humoristik "Shërbëtori i ..."
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI
Shërbëtori i popullit




Policia: Zbërthyer bandën e "9 prillit"

Grabitja e Rinasit, pendohet 34-vjeçari, zbulohen emrat dhe rolet e çdo anëtari

Alkond Bengasi bashkëpunon me drejtësinë. Kush është Veseli, komando i dyshuar për terrorizëm

TIRANË - Indaluar nga policia që prej mbrëmjes të së shtunës në lidhje me grabitjen spektakolare të 6.5 milionë eurove në aeroportin e Rinasit, 34-vjeçari Alkond Bengasi ka vendosur të bëhet bashkëpunëtor i drejtësisë. Burime nga prokuroria dhe bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se i riu e ka fituar statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë, pasi nga dëshmia ...
Në faqen 7

MARREVESHJA ME 10 PIKA: QEVERI TRANSITORE PER TE MBROJTUR DEMOKRACINE

BASHA, PAKT ME 10 PARTI: NUK LEJOJME ZGJEDHJE FASADE

Kryetari i PD komenton "Bindjen Demokratike" të Patozit: S' do ketë opozitë false. Kryemadhi: Largimi i Ramës e afron Shqipërinë me Bashkimin Europian



(Në foto) Kryetari i PD Basha dhe kryetarja e LSI Kryemadhi, gjatë nënshkrimit të marrëveshjes së koalicionit opozitar

PARTIA ME E RE
"Bindja Demokratike" hyn në zgjedhje, Patozi: Ide, jo pronë apo biznes
Në faqen 2

KREU I QEVERISE
Mosregjistrimi në zgjedhje, Rama: Vetëvrasje politike e opozitës
Në faqen 5

DJALE APO VAJZE?
Së shpejti nënë! Politikanet që janë në pritje të ëmbël
Suplement

DHIMETER ANAGNOSTI
Xhirimet e filmit "Gjoleka...", ia dola nga kujdesi i Rozës
Në faqen 18

GUVERNATORI I BSH

Raporti 2018, Sejko: Punësimi u rrit me 1.6%, grabitjet dëmtojnë ekonominë
Në faqen 9

Pedagogu i universitetit "Luarasi" sjell analizën e detajuar mbi informimin e qytetarëve

Stefan Qirici: Ku bazohet ecuria e ardhshme e ekonomisë sonë

Prof. Asoc. Dr.: Pse duhet të investojmë në edukimin ekonomik

NGA VOLTIZA DURO

Qëllimi i edukimit ekonomik është të përmirësojë kuptimin tonë të botës dhe mjedisit ekonomik në të cilën ne jetojmë. Pa këtë kuptim, ne si qytetarë jemi shpesh të hutuar dhe të paafte për të identifikuar,



analizuar dhe interpretuar me sukses aspektet e ndryshme të jetës ekonomike, të cilat janë aq të shumta rreth nesh dhe ndikojnë tek ne në mënyra të ndryshme. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", prof. asoc. Dr. Stefan Qirici ...
Në faqen 10-11

ZGJEDHJET LOKALE VENDIMI

Partia më e re dorëzon kërkesën në gjykatë dhe KQZ, anëtarët dhe kryetari

"Bindja Demokratike" hyn në zgjedhje, Patozi: Ide, jo pronë apo biznes

"Ndryshimi i sistemit dhe çlirimi i zgjedhjeve"

Valentina Madani

Bindja Demokratike dorëzoi dje në Gjykatën e Tiranës kërkesën për regjistrim si forcë politike dhe më pas vendimi kalon në KQZ për t'u regjistruar në zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Dokumentacioni i regjistrimit si parti politike është shoqëruar me rreth 4 mijë firma të mbështetësve për krijimin e saj. Anëtarë të partisë më të re do të jenë Arben Skënderi, Valbona Mezini, Fabian Topollaj, Astrit Patozi, Andi Përmeti dhe Leonard Olli, ndërsa koordinator Astrit Patozi. Nismëtarët e partisë më të re në Shqipëri vendosën të mandatojnë një bord të përkohshëm, i cili do të përfaqësojë partinë deri në ngritjen dhe zgjedhjen e forumeve drejtuese të saj, sipas statutit. Kjo forcë e re politike, që do të ketë në krye ish-nënkryetarin e Partisë Demokratike, Astrit Patozin, dorëzoi në gjykatë dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjithë dokumentacionin e regjistrimit, shoqëruar me rreth 4 mijë firma mbështetësis.

ARSYET

Për Astrit Patozin, "Bindja Demokratike" është dhe do të jetë një ofertë serioze dhe tërësisht e pavarur, sa herë që të ketë zgjedhje në Shqipëri. Patozi e cilëson partinë vetëm ide, jo pronë apo biznes. Në një shkrim të gjatë, Patozi sqaron edhe arsyet e sfaqjes së kësaj partie të re në skenën politike. "Bindja Demokratike" është frymë dhe alternativë e re, në një shoqëri, ku monopoli partitokratik po vret konkurrencën dhe ka kufizuar lirinë e zgjedhjes për qytetarët. Ne jemi të bindur se Shqipëria sot po vuan pasojat e një polarizimi politik, që e ka zanafillën tek vrasja e demokracisë brenda dy partive të mëdha dhe tek konsolidimi i një sistemi mbybës, që garanton palët rivale për mosndëshkueshmëri dhe mbijetesë politike, kundër çdo projekti të ri", - shprehet ai. Patozi sqaroi në një shkrim në faqen e tij në "Facebook", arsyet e themelimit të Bindjes Demokratike dhe thelbin e programit, me betejën kundër sistemit politik aktual. "Bindja Demokratike është frymë dhe alternativë e re, në një shoqëri, ku monopoli partitokratik po vret konkurrencën dhe ka kufizuar lirinë e zgjedhjes për qytetarët. Ne jemi të bindur se Shqipëria sot po vuan



Ish-nënkryetari i PD-së,
Astrit Patozi

"Shtyrja e zgjedhjeve, çfarë të mire na sjell sot?"

30 qershori, Borchardt: Ndryshimi i datës, një proces shumë i ndërlikuar

Mënjëherë pas firmosjes së marrëveshjes me PD-në, partitë opozitare zhvilluan dje një takim me ambasadorin e OSBE-së. Pas një orë diskutimesh, Bernd Borchardt theksoi se janë partitë, që duhet të gjejnë zgjidhje për situatën e krijuar. "Ajo që na takon është që të inkurajojmë partitë politike të gjejnë një zgjidhje, të tregojnë kush zgjidhje është më e mirë. Secila zgjidhje funksionon për një vend, ky është një vendim që i takon sovranit. Politikanët duhet të marrin mendimin e tyre për mënyrën më të mirë të funksionimit", u shpreh z. Borchardt. Duke folur mbi mundësinë e shtyrjes së zgjedhjeve vendore, ai tha se ky është një proces i vështirë, edhe pse është aplikuar më parë. Por pikëpyetje ai ngre nëse kjo është zgjedhja më e mirë. "Kemi një datë zgjedhesh, që është 30 qershori. Ndryshimi i datës



është një proces shumë i ndërlikuar. Shtyrja e zgjedhjeve ka ndodhur në 2007-ën dhe është një mundësi e mirë? Çfarë të mira ka sjellë dhe në fund të fundit çfarë të mire do të sjellë sot shtyrja e zgjedhjeve", tha Bernd Borchardt. Pavarësisht këtij çndrimi, përfaqësuesit e partive të opozitës theksuan dhe njëherë domosdoshmërinë e krijimit të kush-

pasojat e një polarizimi politik, që e ka zanafillën te vrasja e demokracisë brenda dy partive të mëdha dhe te kon-

solidimi i një sistemi mbybës, që garanton palët rivale për mosndëshkueshmëri dhe mbijetesë politike, kundër

BORDI

Një bord i përkohshëm me Arben Skënderin, Valbona Mezinin, Fabian Topollajn, Andi Përmetin e Leonard Ollin me këtë koordinator Patozin do ta përfaqësojë partinë e re deri në ngritjen dhe zgjedhjen e forumeve drejtuese të saj, sipas statutit. Si pjesë e "Bindjes Demokratike" u përfol edhe deputetja Rudina Hajdari, por ajo deklaroi më pas tërheqjen nga nisma.



Firmosja e marrëveshjes
PD-LSI

DEKLARATA

"Bindja Demokratike nuk ka armiq, por vetëm kundërshtarë. Ajo nuk ka miq, por vetëm partnerë. Bindja nuk ka kushërinj, shokë dhe familjarë, sepse ka zgjedhur që në fillim të mbrojë dhe përfaqësojë interesin publik", shprehet z. Patozi.

Apeli i Shehit për "Bindjen Demokratike": Bashkohu me opozitën

Kreu i LZHK, Dashamir Shehi, bëri dje të qartë se do të mundësojë që qytetarët të mos shkojnë në zgjedhje. Pas firmosjes së koalicionit opozitar, Shehi kish tërhequr një thirrje për partinë "Bindja Demokratike", duke thënë se ajo duhet të rreshtohet krahas opozitës së bashkuar. "Kjo është një marrëveshje principi politik. Është një letër e madhe mirëkuptimi politik mes palëve. Është e larguar nga të gjitha këto egoizmat e vogla parazgjedhore. Është beteja që i kemi shpallur Rilindjes dhe zotit Rama. Nga mosregjistrimi fillon beteja", tha z. Shehi. Pyetje se si do t'i pamundësojë zgjedhjet, Shehi u përgjigj: "Me të gjitha mënyrat, duke filluar që me deklarimet tona, duke mos u regjistruar maksimumin e partive, duke mos bërë të mundur që qytetarët të mos shkojnë në zgjedhje. Ditën kur qytetarët nuk shkojnë në zgjedhje, ato kanë rënë. Zgjedhjet minimalisht duan gjysmën e qytetarëve. Të gjitha format nga sot deri ditën e zgjedhjeve. Harku opozitar po zgjerohet për të bërë të pamundur vazhdimin e këtij lloj regjimi".

kësaj force politike". Në shënjestër ai vë dy partitë e mëdha. "Ne mendojmë se fuqia e pakontrolluar e pushtetit të Edi Ramës buron edhe nga pafuqia e opozitës zyrtare, sidomos nga pranimi prej saj i modelit të qeverisjes së partisë dhe më pas qeverisë. Opozita zyrtare e shikon pushtetin e Edi Ramës si model që mund ta shfrytëzojë për vete, kur t'i jepet rasti. Ndërsa ne jemi kategorikisht kundër kësaj. Sepse besojmë se Shqipëria qeveriset, ashtu siç administrohet partia. Nëse nuk bën zgjedhje të

lira në parti, nuk mund të kërkojë zgjedhje të lira në Shqipëri. Nëse nuk lufton korrupsionin në parti, nuk mund ta luftosh atë në Shqipëri", theksoi Patozi. Sipas tij, forca e re politike do të jetë një shtëpi e hapur e lirisë, ku është i mirëpritur gjithkush që gjykon se Shqipëria duhet të çlirohet nga zgjedhja e partitokracisë dhe duhet të dalë nga kjo spirale krizash të vazhdueshme, vetëm pasi njëzërit të kenë mundësi të zgjidhen dhe të zgjedhin lirisht.

REDAKSIONI: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Ltaqa Cel 0682074416, Marketingu: Cel:068087823 e-mail:marketing@gazetashiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Ushinës së Autotransportit, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashiptare.com, SHTYPURINË NË "Klasik" Shpk



Skadimi i afatit për regjistrim në KQZ, negociatat e ndërkombëtarëve me opozitarët

PD krijon koalicionin opozitar, Basha: Pamundësojmë zgjedhjet fasadë

"'Bindja Demokratike', s'do të ketë opozitë false"

Valentina Madani

Partia Demokratike zyrtarizoi dje koalicionin opozitar, duke firmosur marrëveshje bashkëpunimi me 8 prej partive që i janë bashkuar kauzës për të garantuar zgjedhje të lira dhe reformim të thellë të sistemit zgjedhor. Në dokumentin disipikësh, që mori firmat e kryerepublikanit Mediu, atë të përfaqësuesve të LZHK-së, PDK, PAA, LSI-së, PBDNJ, PDIU-së e PLL-së, parti të e opozitës pranojnë të regjistrohen në zgjedhje vetëm pasi të jenë krijuar kushtet për një proces të lirë e të ndershëm. Rruga e vetme thuhet në marrëveshje për të garantuar një garë elektorale të ndershme është formimi i një qeverie transitore, që do të kthejë legjitimitetin politik nëpërmjet zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Sipas marrëveshjes së firmosur nga 8 parti opozitare, qeveria transitore do të ketë për qëllim mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, përgatitjen për zgjedhje vendore dhe parlamentare të lira e të ndershme, realizimin dhe ndjekjen e zbatimit të reformës zgjedhore me fokus shkëputjen e politikës dhe krim-it, si dhe krijimin e klimës së besimit për zbatimin e reformës në drejtësi dhe çdo reforme të nevojshme për përshtetimin e nisjes së negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Europian. Koalicioni opozitar angazhohet në pamundësimin e mbajtjes së zgjedhjeve fasadë të diktuar nga pakti i Edi Ramës me krimin e organizuar dhe paratë e pista, e që ky proces të realizohet përmes përkallëzimit të aksionit opozitar në të gjithë vendin. Më radhë aleatët e demokratëve firmosën njëri pas tjetrit dokumentin me 10 pika, ku pranuan se nuk do futen në zgjedhje pa u plotësuar kushti për një proces të lirë dhe të ndershëm, të cilat duhet të organizohen nga një qeveri tranzitore. Reforma zgjedhore dhe ajo në drejtësi pritet të jenë në mandatin e qeverisë transitore, e deri në atë ditë opozita pritet të përshkallëzojë qëndrimin për të për të pamundësuar zgjedhjet nëse do të mbahen pa një **PARALAJMËRIMI**

ndëshkuar më parë krimi elektorale. Basha paralajmëroi se në orët në vijim koalicioni do të zgjerohet me parti të tjera dhe se hap i panegociueshëm është largimi i Edi Ramës nga qeveria. Koalicionit u bashkuan Partia Konservatore, Partia Mendimi i Djathtë Liberal dhe Partia Popullore Kristian Demokratë, duke e çuar kështu në 11 numrin e partive në koalicion. "Kurrë më nuk do të pranojmë një proces zgjedhor fals, që prodhon një parlament fals, qeveri false. Do të angazhohemi që zgjedh-

jet e ardhshme të jenë të lira dhe të ndershme, ku të diktohet vullneti i ri shqiptar. Angazhohemi t'i japim fund krizës kushtetuese funksionimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të një prokurorie që heqon me një standard dhe jo me dy standarde. Akti i parë i këtij koalicioni do të jetë formësimi i platformës për zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe reformimi i thellë i sistemit politik dhe ndarja e krizës ekonomike. Hap i panegociueshëm mbetet zgjidhja politike, largimi i shkakhtarit

të kësaj gjendjeje, largimi i atij që shkatërroi policinë, arsimin, solli drejtësinë false, po shkatërron shtetin e shqiptarëve, largimi i Ramës dhe një qeveri transitore. Nuk do të ketë zgjedhje farse pa u ndëshkuar krimi elektorale dhe u pa vënë para përgjegjësisë Rama dhe bashkëpunëtorët e tij Dako, Gjilnuri", deklaroi kreu i PD-së. Por, teksa Lulzim Basha dhe aleatët e tij paralajmërojnë bojkot të zgjedhjeve, futjen në garën për vendoret e 30 qershorit të Partisë "Bindja Demokratike", kreu i demokratëve e sheh si pjesë së një procesi fasadë. "Gjeneza e së keqes ku ndodhemi janë zgjedhjet false të diktuar nga krimi. Nuk do të ketë më parlament fals, qeveri false, drejtësi false dhe natyrisht, as opozitë false", u shpreh kreu i PD-së. Pas zyrtarizimit të koalicionit opozitar, Lulzim Basha priti dje në zyrën e tij ambasadorin e Bashkimit Europian në Tiranë, Luigi Soreca. Më herët, menjëherë pas firmosjes së marrëveshjes me PD-në, parti të opozitare zhvilluan një takim me ambasadorin e OSBE-së. Pas një orë diskutimesh, Bernd Borchardt theksoi se janë parti të që duhet të gjejnë zgjidhje për situatën e krijuar.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha me kreuin e PR-së, Fatmir Mediu

AKUZA

Kreu i FRPD, Belind Këlliçi, akuzoi dje qeverinë se sipas tij, këto 6 vite ka punuar për largimin e shqiptarëve nga vendi. Përmes publikimit të një videoje, ai tregoi se disa studentë i kanë "dhuruar", ministrin të Turizmit, Blendi Klosi, hartën e Shqipërisë, që e pasqyrojnë vendin si një republikë e kanabisi.

PARTITË E OPOZITËS, MARRËVESHJE ME 10 PIKA: ZGJEDHJE, VETËM ME QEVERI TRANSITORE

- 1-Krijimin e një koalicioni të bashkuar opozitar dhe qytetar për zgjedhjet e ardhshme në vend.
- 2-Partitë nënshkruese të këtij koalicioni do të regjistrohen në zgjedhje vetëm pasi të jenë krijuar kushtet për zgjedhje të lira dhe të ndershme.
- 3-Rruga e vetme për të garantuar zgjedhjet e lira dhe të ndershme është formimi i një qeverie transitore me mandat të posaçëm për: Kthimin e legjitimitetit politik të qeverisë në vend nëpërmjet zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Përgatitjen e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme parlamentare dhe vendore në Shqipëri. Krijimin e klimës së besimit për zbatimin e reformës në drejtësi jashtë çdo ndërhyrjeje politike. Krijimin e kushteve të nevojshme për të përshtetuar nisjen e negociatave të Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Europian dhe ndërmarrjen e çdo reforme të nevojshme për këtë qëllim.
4. Në mbrojtje të demokracisë dhe të zgjedhjeve të lira e të ndershme, parti të nënshkruese të këtij koalicioni angazhohen të mos lejojnë asnjë farsë elektorale të organizuar nga qeveria ilegjitime e Edi Ramës.
5. Pamundësimi i mbajtjes së zgjedhjeve fasadë, të diktuar nga pakti i Edi Ramës me krimin e organizuar dhe paratë e tyre të pista të realizohet përmes përkallëzimit të aksionit opozitar në të gjithë vendin.
6. Rikonfirmojmë vullnetin tonë se integrimi europian i Shqipërisë është rruga e vetme për t'i dhënë fund tranzicionit të tejgjatuar. Shprehim vendosmërinë tonë të plotë për të ndërmarrë çdo hap, që bën realitet rugëtimin e pandalshëm dhe të shpejtë të Shqipërisë në familjen europiane.
7. Angazhohemi për të unifikuar dhe miratuar një platformë të përbashkët për çlirimin e ekonomisë nga oligarkia dhe krimi me mbështetje qeveritare. Ky trinom është përgjegjës për rritjen e papunesisë, largimin e investimeve të huaja, falimentimin e fermerëve dhe sipërmarrjes private. Kjo platformë e përbashkët ka për qëllim nxjerrjen e vendit nga kriza e rëndë ekonomike për të krijuar punësim, zhvillim, mirëqenie dhe mundësi të barabarta për të gjithë.
8. Angazhohemi për luftë pa kompromis ndaj krim-it të organizuar, korrupsionit dhe pastrim-it të parave të pista, si pengesa kryesore për stabilitetin dhe zhvillimin e vendit, sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve.
9. Mbështesim çdo qytetar, të drejtat dhe liritë themelore të të cilët dunojnë nga veprimet arbitrare të institucioneve shtetërore.
10. Angazhohemi për një marrëdhënie politike dhe elektorale me çdo individ apo parti politike, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe integritetit të nënshkruese. Firmatarët e marrëveshjes: PD, LSI, PR, LZHK, PAA, PBDNJ, PDIU, Partia e Legalitetit, Mendimi i Djathtë Liberal.

Marrëveshja, Kryemadhi: Largimi i Ramës e afron Shqipërinë me BE-në

Pas nënshkrimin të marrëveshjes së koalicionit opozitar, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, bëri të qartë se opozita nuk do të ndalet deri në largimin e Edi Ramës nga pushteti. "Këtu nuk është problemi të Edi Rama si individ. Këtu është problemi Edi Rama si fenomen. Po flasim për atë që është telekomanda e krim-it të organizuar shqiptar dhe ndërkombëtar", tha Monika Kryemadhi, kryetarja e LSI-së. Sipas saj, "aksionit opozitar i shtohet një element tjetër i rëndësishëm. Për të gjithë skeptikët, tashmë kanë strategjinë dhe platformën e opozitës". "Zoti e ka vendosur në mes të Europës. Çdo përpjekje e Ramës për ta mbajtur Shqipërinë larg BE-së është e dështuar. Çdo ditë që ai zgjat, e largon Shqipërinë nga BE-ja, largimi i Ramës e afron Shqipërinë me BE-në", tha Kryemadhi.

FATMIR MEDIU

"Është detyra më fisnike e çdo politikani apo force politike të garantojë të drejtën kushtetuese për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Kjo është përgjegjësi kushtetuese dhe qytetare, që opozita do t'i shkojë deri në fund. Zgjedhje do të ketë vetëm në kushtet kur qytetarët të mund të votojnë të lirë", tha kreu i PR-së.

SHPËTIM IDRIZI

"Edi Rama nuk mund të tentojë të përsërisë Ramiz Alinë e vitit 1991, që u fut në zgjedhje me Partinë e Punës dhe me Bashkimet Profesionale. Si forca politike opozitare, të mos vrapojmë të regjistrohemi për t'u bërë pjesë e farsës elektorale, por të bashkohemi për t'i dhënë Shqipërisë një zgjidhje politike", tha kreu i PDIU.

AGRON DUKA

"Morëm angazhim që ne nuk hujmë në zgjedhjet farse. Jemi të vendosur në rrugën e zgjedhjeve të ndershme dhe asnjë nuk do çdojë në këtë gjë të rëndësishme, siç janë zgjedhjet e lira. Diskutuum edhe problemet e bujqësisë, ku vendosëm si koalicion të jemi këmbëngulës për të plotësuar nevojat që kanë fermerët", - theksoi kreu i PAA-së.

VANGJEL DULE

"Edi Rama çdo sekondë që ri më tepër në pushtet, është kosto më tepër në jetën e shoqërisë sonë dhe të brezit të ardhshëm. Qytetarë, reflektoni! E keqja është e përbashkët, të gjithë bashkë do ta heqim! Duhet t'i themi 'ndal' këtij fenomen. Rama që ka vënë në rrezik çdo perspektivë të këtij vendi", deklaroi kreu i PBDNJ.

ZGJEDHJET VENDORE PARTITË

KQZ miratoi në mbledhjen e djeshme kërkesën e 9 partive të tjera si subjekte zgjedhore

Skadon afati, opozita s'registrohët, në zgjedhjet vetëm 40 parti

Në KQZ kanë paraqitur kërkesë edhe 7 parti

Rreth 40 parti politike kanë pranuar që të regjistrohen për të marrë pjesë në zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi kërkesën e 9 subjekteve të tjera politike, duke e çuar kështu në 34 numrin total të partive të regjistruara zyrtarisht në zgjedhjet për pushtetin lokal. Ndërkohë që burime nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bëjnë me dije se janë edhe rreth 7 parti të tjera politike që kanë paraqitur kërkesë pranë këtij institucioni për t'u regjistruar në zgjedhjet e ardhshme lokale, duke e çuar kështu në mbi 40 numrin total të partive që do jenë në fletën e votimit të 30 qershorit.

MBLEDHJA

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar gjatë mbledhjes së djeshme edhe kërkesën për regjistrimin 9 partive të tjera, kryesisht forca të djathta apo që janë në opozitë me qeverinë. Kështu, KQZ votoi me 5 vota vendimin për regjistrimin si subjekt zgjedhor: Partia e Reformave Demokratike Shqiptare me kryetar Krenar Rryçi, Partia Demokratike Sociale me kryetar Paskal Milo. Gjithashtu, KQZ vendosi të regjistrojë Partinë Zgjidhja, me kryetar Koço Kokëdhima, si subjekt zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, si dhe Partinë e Pajtim-it Kombëtar, me kryetar Spartak Dobi. Po ashtu KQZ vendosi të regjistrojë Partinë Socialpunëtore Shqiptare, me kryetar Ramadan Ndreka, si dhe Partinë Ligj dhe Drejtësi me kryetar Spartak Ngjëlën. Gjatë kësaj mbledhje u mor parasysh edhe kërkesa e Partisë Fryma e Re Demokratike me kryetar Bamir Topin për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019. Gjithashtu, një tjetër parti politike që do marrë pjesë në zgjedhjet vendore të 30 qershorit është edhe Partia Aleanca Kuq e Zi me kryetar Lumturi Ratkoceri. Partia e fundit në listën e subjekteve të regjistruara dje nga KQZ,



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

'BINDJA'

Menjëherë pas regjistrimit në Gjykatën e Tiranës kjo forcë ka paraqitur kërkesën për regjistrim edhe në KQZ. Një tjetër parti që ka paraqitur kërkesë për regjistrim në zgjedhje është edhe Partia e Ballit Kombëtar me kryetar Adriatik Alimadhi. Gjithashtu, në KQZ ka paraqitur kërkesë për të marrë pjesë në zgjedhje edhe Partia G99 e Ervin Metes.

'LIBRA' u regjistrua në zgjedhje, Blushi: Nuk kandidoj

Një nga forcat politike që u regjistruan dje si subjekte që do marrin pjesë në zgjedhjet vendore të 30 qershorit është edhe LIBRA ose Lista e Barabartë që kryesohet nga Ben Blushi. "Partia Lista e Barabartë, me shkronja nistore "LIBRA", nëpërmjet përfaqësueses të posaçme, Matilda Beqiri, e autorizuar nga kryetari z. Ben Blushi, ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet", - thuhet në relacionin e KQZ. Ndërkohë që vetë, Ben Blushi në një prononcim për "Panorama" thekson se ai është habitur nga regjistrimi i LIBRA me emrin e tij. "Gati 1 vit pasi u



Kryetari i 'LIBRA', Ben Blushi

largova nga politika sot u binda për të disatën herë që kam marrë vendimin e duhur kur dëgjova se KQZ me ka regjistruar në zgjedhje si kryetar i LIBRA, partisë që kam drejtuar deri në janar të vitit 2018. Megjë ky lajm me ka habitur si mua ashtu dhe ata që e kanë përhapur dua t'i siguroj

të gjithë se unë nuk kandidoj dhe nuk drejtoj asnjë parti në zgjedhjet e ardhshme lokale. Ndërkohë kam komunikuar zyrtarisht me KQZ për t'i kërkuar të më regjistrojë nga fleta e votimit. Shpresoj të më lehtësojnë nga siklet për të kandiduar me pahir", - thekson Ben Blushi.

ishte edhe Partia Lista e Barabartë e drejtuar nga Ben Blushi. "KQZ vendosi të regjistrojë Partia Lista e Barabartë, me kryetar z. Ben Blushi, si subjekt zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019", - thuhet në njoftimin e KQZ. Kështu

nisur nga fakti se më parë KQZ ka regjistruar 25 parti, së bashku me 9 forcat e tjera të regjistruara dje, numri i subjekteve zgjedhore të regjistruara si pjesëmarrëse në zgjedhje deri më tani është 34. **REGJISTRIMET** Ndërkohë që brenda

afatit ligjor që skadoi dje, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë paraqitur kërkesë për t'u regjistruar si subjekte zgjedhore edhe 7 parti të tjera. Nuk dihet ende me saktësi emrat e të gjitha partive që kanë paraqitur kërkesë dhe që presin të regjistrohen nga KQZ,



Një nga mbledhjet e Asamblesë së PS-5

PARTITË E REGJISTRUARA NË ZGJEDHJE, NGA KOMUNISTËT TE BALLISTËT

1. Partia Socialiste e Shqipërisë - Edi Rama
2. Partia Socialdemokrate Shqiptare - Skënder Gjinushi
3. Partia e Gjelbër - Edlir Petanaj
4. Partia Kristian Demokratike - Dhimitër Muslija
5. Partia Aleanca Demokratike - Zef Bushati
6. Partia Socialiste e Moderuar - Gjergji Koja
7. Partia Unitetit Kombëtar - Idajet Beqiri
8. Partia Emigracionit Shqiptar - Kostaq Papa
9. Partia e Personave me Afësi të Kufizuar - Gjovalin Shqalshi
10. Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare - Genci Sakaj
11. Partia e të Drejtave të Mohuara - Ilir Vata
12. Partia Demokratia e Re Europiane - Koçi Tahiri
13. Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane - Valentino Mustafa
14. Partia Demokratike për Integrim dhe Prosperitet - Kujtim Muça
15. Partia Ardhmëria Shqiptare - Emin Subashi
16. Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen - Kristo Kijo
17. Partia për Demokraci dhe Solidaritet - Gaqo Apostoli
18. Partia për Mbrojtjen e të drejtave të emigranteve - Ymer Kurti
19. Partia Komuniste e Shqipërisë - Qemal Cicolari
20. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar - Ylber Valteri
21. Partia Ora e Shqipërisë - Zef Shtjefni
22. Partia Bashkimi Liberal Demokrat - Arian Starova
23. Partia për Liri, Demokraci dhe Etikë - Arian Galdini
24. Partia Kombëtare Konservatore - Kujtim Gjuzi
25. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve - Kadri Isufaj
26. Fryma e Re Demokratike - Bamir Topi
27. Lista e Barabartë - Ben Blushi
28. Partia Zgjidhja - Koço Kokëdhima
29. Partia Demokratia Sociale - Paskal Milo
30. Partia Ligj dhe Drejtësi - Spartak Ngjëlën
31. Partia Socialpunëtore Shqiptare - Ramadan Ndreka
32. Partia e Reformave Demokratike - Krenar Rryçi
33. Pajtimi Kombëtar Shqiptar - Spartak Dobi
34. Aleanca Kuq e Zi - Kreshnik Spahiu

PARTITË QË KANË BËRË KËRKESË NË KQZ

35. Partia Bindja Demokratike - Astrit Patozi
36. Partia Balli Kombëtar - Adriatik Alimadhi
37. Partia G99 - Ervin Mete

por bien në sy disa prej tyre. Kështu, një prej partive që kanë paraqitur në KQZ kërkesën është Partia Bindja Demokratike e Astrit Patozi. Menjëherë pas regjistrimit në Gjykatën e Tiranës kjo forcë ka paraqitur kërkesën për regjistrim edhe në KQZ. Një

tjetër parti që ka paraqitur kërkesë për regjistrim në zgjedhje është edhe Partia e Ballit Kombëtar me kryetar Adriatik Alimadhi. Gjithashtu, në KQZ ka paraqitur kërkesë për të marrë pjesë në zgjedhje edhe Partia G99 e Ervin Metes.



Kreu i qeverisë ka përjashtuar mundësinë e shtyrjes së zgjedhjeve vendore

Mosregjistrimi në zgjedhje, Rama: Vetëvrasje politike e opozitës

"Humbësit kronikë janë peng i dëshpërimit të tyre"

Shumica qeverisëse është e vendosur që të mos bëjë asnjë hap pas sa i përket mbajtjes së zgjedhjeve vendore në 30 qershor. Ndërsa opozita e bashkuar arriti marrëveshjen e bashkëpunimit për të mundësuar zgjedhje të lira dhe të ndershme pa Edi Ramën kryeministër, ky i fundit nëpërmjet një komenti në rrjetet sociale reagoi duke konfirmuar edhe një herë vendosmërinë e mazhorancës që ai drejton për t'i mbajtur zgjedhjet lokale pikërisht në datën e dekretuar nga presidenti, më 30 qershor. "Zgjedhjet as ndalen, as shtyhen. Në 30 qershor qytetarët do flasin me votë në çdo bashki".

ZGJEDHJET

Rama nëpërmjet një komenti në rrjetet sociale reagoi duke konfirmuar edhe një herë vendosmërinë e mazhorancës që ai drejton për t'i mbajtur zgjedhjet lokale pikërisht në datën e dekretuar nga presidenti, më 30 qershor. "Zgjedhjet as ndalen, as shtyhen. Në 30 qershor qytetarët do flasin me votë në çdo bashki".



Vetëvendosja regjistrohet në gjykatë, prezantimi në mes të majit

Lëvizja Vetëvendosje regjistrohet zyrtarisht si subjekt politik në Shqipëri. Gjykata e Tiranës e ka marrë vendimin javën e kaluar për regjistrimin e Qendrës "Lëvizja Vetëvendosje" në Shqipëri me statusin e organizatës jo fitimprurëse. VV e vlerëson këtë vendim të marrë bazuar mbi ligjet dhe shtetin e së drejtës. Drejtori ekzekutiv i "Lëvizja Vetëvendosje" në Shqipëri, Bojken Abazi thotë se ky akt është vazhdimësi e aktivitetit të VV-së disa vjeçar në Republikën e Shqipërisë, por tashmë në një formë të re. "Në qëllim dhe motiv, në parim dhe veprim, përmes këtij themelimi ne do të angazhohemi për aspiratat shekullore të shqiptarëve për bashkim kombëtar, ashtu siç shprehet edhe në Preambulën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, bashkë me përpjekjen për një shtet zhvillimor që lufton pabarazitë e mëdha ekonomike që janë krijuar. Frymëzimi ynë rrjedh edhe nga përfytyrimi i të ardhmes për vendin tonë, si vend që ia mundëson grupeve e shtresave të ndryshme shoqërore dhe individëve shpërthimin e potencialeve të tyre, duke zhvilluar e mbrojtur ekonominë e përbashkët dhe atë individuale me drejtësi, demokraci, transparencë dhe përgjegjësi në vendimmarrje. Përmes kësaj forme të organizimit synojmë të bashkëpunojmë me sa më shumë aktorë të shoqërisë civile, akademike, qytetarë aktivë dhe ekspertë të fushave të ndryshme anembanë Republikës, të gjithë treqeja si dhe në mërgatë", - thuhet në deklaratë. Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Shqipëri do të organizojë inaugurimin në Tiranë për të shënuar fillimin e këtij organizimi të ri, në mes të muajit maj.

ASAMBLEJA

Burime nga PS-ja bënë me dije se mbledhja e këtyre dy forumeve të rëndësishme drejtuese dhe vendimmarrëse në PS ka të bëjë pikërisht me çështjet zgjedhore dhe për t'i përcjellë mesazhin opozitës se socialistët janë të vendosur që të shkojnë në zgjedhje. Kështu, gjatë mbledhjes së asamblesë që do mbahet javën e parë të majit, mësohet se PS-a do miratojë në mënyrë demonstrative kandidatët për kryetar bashkie në të gjitha bashkitë.



Kryeministri Edi Rama

DEBATI

Ndërkohë që grupi parlamentar diskutoi edhe për çështjet që pritet të jenë në rend të ditës së seancës plenare që do mbahet nesër, ku një nga nismat më të rëndësishme është edhe ajo që trajton statusin e Policisë Gjyqësore. Burime nga grupi kanë bërë të ditur se në mbledhje deputeti Bashkim Fino ka kërkuar rishikimin e pagave për oficerët e policisë gjyqësore. Sipas Finos, me pagat e reja, policët gjyqësorë marrin paga më të larta edhe se presidenti. Kërkesë, e cila nuk u pranua nga kolegët e tij në mbledhjen e grupit parlamentar. Sakaq, në fjalën para deputetëve socialistë, kryetari i grupit parlamentar, Taulant Balla ka kërkuar prej deputetëve më shumë angazhim e të jenë më prezentë në zonat elektorale. Kreu i grupit parlamentar të PS-së ka kërkuar përgatitje dhe kontakte me elektoratin në funksion të përgatitjeve për zgjedhjet lokale.

Meta takon zv.presidentin e PE: Mirënjohje për mbështetjen për integrimin

Kreu i shtetit, Ilir Meta, takoi dje Zëvendës-presidentin e Parlamentit Europian dhe eurodeputetin e lëvizjes "5 Yjet", Fabio Massimo Castaldo. Meta, ndërsa falënderoi Castaldo për angazhimin e tij lidhur me forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Italisë, shprehu mirënjohje edhe për atë që e cilësoi mbështetje të fortë në procesin e integrimit të vendit në BE. Nga ana tjetër, Zv. presidenti i PE, Castaldo e siguroi kreun e shtetit shqiptar për mbështetjen e tij dhe të Italisë në këtë proces. Po dje Presidenti Ilir Meta firmosi dekretin për Gazmend Barbulushin, në detyrën e ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës dhe jorezident në Mbretërinë e Marokut, në Republikën Islamike të Mauritanisë dhe në Principatën e Andorrës. "Z. Gazmend Barbulushi emërohet në detyrën e ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Spanjës, rezident, si dhe ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Marokut, në Republikën Islamike të Mauritanisë si edhe në Principatën e Andorrës, jorezident", thuhet në dekretin e z.Meta.



Tre kandidatë të tjerë marrin mandatin, Kuvendi me 110 anëtarë

Ka shkuar në 110 numri i deputetëve me mandat në Kuvendin e Shqipërisë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u dha dje mandatin 3 kandidatëve të tjerë që vijnë nga listat shumëmërore të Partisë Demokratike. Më konkretisht, mandatin e deputetit e mori Artur Rroshi nga lista e PD-së në Tiranë, Nikolin Staka dhe Zef Shtjefni nga lista e PD-së në Shkodër. Ndryshe nga shumë kandidatë të mëparshëm, ata kanë edhe një veçori tjetër: pasi janë kryetarë të partive aleate me PD-në. Kështu, Zef Shtjefni kryetar i Partisë "Ora e Shqipërisë", Artur Koshi kryetar i Partisë Balli Kombëtar Demokrat dhe Nikolin Staka kryetar i partisë Lëvizja Demokratike për Ndryshim. Të tre deputetët e rinj pritet të bëhen në Kuvend, në seancën e radhës plenare. Me betimin e tyre, numri i deputetëve në parlament shkon në 110, ndër të cilët 79 nga mazhoranca, 14 nga LSI-ja dhe 17 nga PD-ja.

TIRANË - Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka vendosur të shtyjë sërish gjyqin ndaj grupit të Emiljano Shullazit. Mësohet se shkak për shtyrjen e gjyqit është bërë mosnjohja e palës së dëmtuar në veprën penale. Gjithashtu, gjyqi ndaj grupit duhet të nisë nga e para, pasi janë ndryshuar edhe gjyqtarët, ndërsa njëri nga anëtarët e grupit, konkretisht Blerim Shullazi, kërkoi përjashtimin e gjyqtarës Sai-



Shkak i shtyrjes së seancës, mosnjohja e palës së dëmtuar

Apeli shtyn për të 7-ën herë gjyqin për grupin e Shullazit

da Dollani. Nga çështja janë larguar Fehmi Petku dhe Sokol Binaj. Gjykata së Krimeve të Rënda e dënoi Emiljano Shullazin me 14 vite burg. Po ashtu, togat e zeza dhanë vendimin edhe për pjesëtarët e bandës së tij, duke i dënua në total me 55 vite burg, por ky vendim u apelua. Konkretisht, Gilmando Dani u dënu me 12 vjet burg, Endri Qyqa 10 vjet burg, Endri Zela 10 vjet burg dhe Blerim Shullazi 9 vjet burg. Emiljano Shullazi u shpall fajtor për gjobënie ndaj biznesmenit Ylvi Beja dhe Jani Zako, por shpëtoi nga akuzat për shkatërrim të pronës me eksploziv për dy raste dhe kanosjes së dy profesorëve Mynyr Koni dhe Dhori Kule. Kjo është hera e shtatë që shtyhet seanca për Emiljano Shullazin dhe anëtarët të tjerë të grupit.


Mjekët hidhen në protestë: Policia u nxitua me arrestimin e 2 kolegëve tanë

ELBASAN

Një ditë pas vdekjes së 25-vjeçares Rexhina Debrova pas lindjes cezariene, ka dalë edhe rezultati i autopsisë së mjekësisë ligjore. Sipas rezultatit të autopsisë, bëhet me dije se shkak i vdekjes së saj është "koagulimi", i cili është një lloj mpiksje gjaku, që shkakton trashjen e tij deri në tharjen përfundimtare. Për pasojë thuhet në raportin zyrtar të autopsisë vdekja ka ardhur nga mpiksja e gjakut nga i cila i është bllokuar një nga venat kryesore që çon gjakun në mushkëri, duke shkaktuar vdekjen e menjëhershme. Në mjekësi "koagulimi" është i rrallë, por më i shpeshtë te ndërhyrjet gjatë lindjes. Në lidhje me vdekjen e së resë u pranngosën dy mjekët të spitalit të Elbasanit. Arrestimi i kardiologut Mehmet Iba dhe reanimatorit Nikollaq Thana kanë indinjuar bluzat e bardha të Elbasanit, të cilët ditën e djeshme u hodhën në protestë. Ata kanë pezulluar të gjitha operacionet, duke u shprehur se ndihen të pasigurt. Ndërkaq, kanë reaguuar ashpër drejtuesit e këtij spitali. Teksa i kanë shprehur ngushëllime familjes së 25-vjeçares, e cila humbi jetën ditën e hënë një orë pas lindjes, ata kanë dënuar me ashpërsi arrestimin e dy mjekëve. Në reagimin zyrtar dënohet me ashpërsi fakti i arrestimit të dy mjekëve para rezultateve të autopsisë, e cila në fund tregoi se nëna e re ka pasur një komplikacion dhe vdekja e saj nuk ka ardhur nga pakujdesia.

Vdekja e 25-vjeçares Rexhina Debrova një orë pas lindjes, del rezultati i autopsisë

Raporti, e reja humbi jetën nga koagulimi i gjakut



25-vjeçares Rexhina Debrova



Mjekët e Elbasanit në protestë

PROTESTA

Bluzat e bardha të Elbasanit dje u hodhën në protestë, në shenjë solidarizimi me dy kolegët e tyre, që u arrestuan të hënë pas vdekjes së 25-vjeçares Rexhina Debrova. Arrestimin e mjekut kardiologut, Mehmet Iba dhe reanimatorit Nikollaq Thana, bluzat e bardha e kanë cilësuar si një masë ekstreme dhe shumë të nxitur nga ana e policisë. Ata kanë pezulluar të gjitha operacionet, duke u shprehur se ndihen të pasigurt.

AKUZA NDAJ POLICISË

Mjeku reanimator Nikollaq Thana dhe kardiologu Mehmet Iba janë arrestuar para se të dilnin rezultatet e autopsisë së mjekësisë ligjore nga të cilat përcaktohet shkak i vërtetë i vdekjes së 25-vjeçares që ndërroi jetë një orë pas lindjes me operacion në maternitetin e Elbasanit. "Është për të ardhur keq që policia tregohet kaq e shpejtë në aksionet për arrestimin e bluzave të bardha, që shpëtojnë pafund jetë njerëzore pa pasur në dorë fakte që i fajësojnë ata në kryerjen e detyrës".

keq që policia tregohet kaq e shpejtë në aksionet për arrestimin e bluzave të bardha që shpëtojnë pafund jetë njerëzore pa pasur në dorë fakte që i fajësojnë ata në kryerjen e detyrës. Natyrisht që ne nuk mbrojmë askënd që është përgjegjës para ligjit, por jemi të shokuar nga pranngosja pa asnjë fakt që fajëson kolegët Thana e Iba. Me keqardhje e themi që policia në ndonjë rast nuk është treguar kaq e shpejtë për t'i mbrojtur bluzat e bardha kur iu është kërcënuar jeta apo dhe kur pengohemi në kryerjen normale të detyrës. Prandaj kërkojmë që të tregohet respektimi i të gjitha procedurave në rastet e ndalimit të mjekëve kur ka ngjarje si ajo e ditës së hënë. Bluzat e bardha të Elbasanit garantojnë të gjithë qytetarët se pacientëve të Qendrës Spitalore të Elbasanit gjithmonë dhe në çdo kohë iu është dhënë dhe do t'u jepet shërbimi mjekësor më i mirë i mundshëm. Ndërkohë kërkojmë që të kemi mirëkuptimin e të gjithëve gjatë kryerjes së punës si profesionistë dhe nuk lejojmë askënd të spekulojë ndaj bluzave të bardha".

Ministri italian, Salvini: Asnjë lëshim ndaj kriminelëve

Arrestohet 28-vjeçari i kërkuar në Itali për terrorizëm

ELBASAN - Një 28-vjeçar ka përfunduar dje në pranga, pasi konsiderohet si një person me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Bëhet fjalë për Ledar Ibrahim, banues në Elbasan. "Në vijim të punës për parandalimin e terrorizmit, si dhe për kapjen e personave të shpallur në kërkim ndërkombëtar për terrorizëm, strukturat e Drejtorisë së Antiterrorit në Policinë e Shtetit, si rezultat i informacioneve të marra dhe punës investigative organizuan dhe finalizuan në bashkëpunim me Interpol Tirana dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, operacionin për kapjen e një personi me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Si rezultat i operacionit, nga agjentët e



Antiterrorit u bë e mundur kapja dhe arrestimi me qëllim ekstraditim e shtetasit shqiptar B. I., 28 vjeç, banues në Elbasan", sgaroi policia. Arrestimi i këtij shtetasi u bë për arsye se Interpol Roma në datë 15.04.2019 e ka shpallur në kërkim ndërkombëtar, mbi bazën e vendimit të arrestit të lëshuar nga

Prokuroria e Republikës Italiane në mars 2019, për veprën penale "Pjesëmarrje në organizatë terroriste, parashikuar nga neni 270 i Kodit Penal italian. Ky person më parë është deportuar nga Italia si person i rrezikshëm për rendin dhe sigurinë publike në Itali, pasi dyshohet të jetë i përfshirë me organizatë terroriste në Itali dhe Egjipt. Materialet në ngarkim të këtij shtetasi i kaluan prokurorisë për veprime të mëtejshme. Ndërkaq, pas arrestimit të tij ka reaguuar ministri i Brendshëm i Italisë, Mateo Salvini. Në një postim në "Facebook", Salvini ndër të tjera ka falënderuar policinë shqiptare për arrestimin, ndërsa shton se nuk ka lëshim ndaj kriminelëve.

REAGIMI I SPITALIT

"Qendra Spitalore 'Dr. Xhaferi Kongoli' Elbasan edhe njëherë shpreh dhimbjen e thellë për humbjen e jetës së pacientes nga lagjia 'Vullnetari' Elbasan. Gjithashtu, mjekët e Elbasanit pas arrestimit të dy kolegëve shprehin indinjatën dhe shqetësimin maksimal për arrestimin e dy kolegëve, një masë ekstreme kjo e marrë ndaj tyre. Arrestimi i kolegëve tanë nga ana e policisë është një nxitim i tepruar i policisë, pasi ata jo vetëm që janë mjekë jashtëzakonisht të nderuar, por edhe nga më të përkushtuarit në kryerjen e detyrës.

Mjeku reanimator Nikol-

Arrestohet autori i 5-të i ngjarjes. Elton Pikli nga Kruja po tentonte të ikte në Bullgari

Pendohet grabitësi i Rinasit, Alkond Bengasi zbuloi emrat dhe rolet e anëtarëve të bandës

Krimet e Rënda dje vendosën masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj bashkëpunëtorit të drejtësisë

TIRANË

Indaluar nga policia që prej mbrëmjes të së shënës në lidhje me grabitjen spektakolare të 6.5 milionë eurove në aeroportin e Rinasit, 34-vjeçari Alkond Bengasi ka vendosur të bëhet bashkëpunëtor i drejtësisë. Burime nga prokuroria dje bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se i riu e ka fituar statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë, pasi nga dëshmia e tij është mundur të shkohet tek Klement Çala, njëri prej organizatorëve të megagrabitjes së 9 prillit dhe anëtarët e tjerë të bandës, për të cilët ai kishte dijeni. Sipas burimeve nga organi i akuzës, Bengasin e ka tradhtuar një gjurmë gishi, të cilën e kishte lënë në furgonin e grabitjes që kishin mbishkrimin "Hetimi Tatimor". Ditën e djeshme Gjykata për Krime të Rënda ka dhënë masën "arrest me burg" për Bengasin, i cili është kushëriri i "mjeshtrit" të grabitjeve, Klement Çala. Ndërkaq, mesnatën e së hënës është arrestuar personi i 5-të i grabitjes në Rinas. Ai është 32-vjeçari Elton Pikli nga Kruja. Sipas burimeve policore Pikli, i cili nuk rezultoi të jetë person i skeduar u kap në Qafë-Thanë teksa po tentonte të largohej drejt Bullgarisë. Materialet procedurale në ngarkim të tij i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për veprat penale "Vjedhje me armë të kryer në bashkëpunim, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal", "Mbajtje pa leje e armëve dhe municioneve luftarake", "Vrasje e punonjësit të policisë e kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë".

GRABITËSI I PENDUAR

Sipas hetuesve të çështjes, Alkond Bengasi ka pranuar të bashkëpunojë dhe të rrëfejë të gjithë skemën e supergrabitjes në aeroportin "Nënë Tereza" të Rinasit, se kush janë autorët dhe si ishin organizuar. Bëgo po ashtu ka rrëfyer me detaje se si funksiononte ky grup me personazhe nga Elbasani dhe Fushë-Kruja. Nga dëshmia e tij, dhënë deri tani, është bërë e mundur të mësohet se si u modifikua furgoni me mbishkrimin "Hetimi Tatimor" në servisën e Eldi Çalës në Elbasan, vëllai i Klement Çalës. Gjithashtu, ai ka qenë personi i cili ka dhënë dhe emrat e tre personazheve të tjera të përfshirë në ngjarjen e rëndë. Bëhet fjalë për shtetasit Saimir Çela, Renaldo Sula dhe Oltion Veseli, që u arrestuan gjatë fundjavës së kaluar. Bazar në dëshminë e dhënë nga 34-vjeçari, prokuroria dhe policia ka arritur të mbledhë prova të tjera, të cilat kanë



I arrestuari Elton Pikli



I penduari i drejtësisë, Alkond Bengasi

Oltion Veseli, imami "komando" i grabitjes në Rinas, u arrestua nga amerikanët për terrorizëm

TIRANË - Dy javë nga grabitja spektakolare në aeroportin e Rinasit ka përfunduar në pranga një prej autorëve që hyri në pistë. Bëhet fjalë për 38-vjeçarin Oltion Veseli nga Fushë-Kruja, i cili dyshohet të jetë një nga pesë personat që u futën me furgon në pistën e aeroportit të Rinasit, duke vjedhur miliona euro të bankave të nivelit të dytë, teksa do të transportoheshin me avion në Vjenë. Mësohet se Veseli, i vënë në pranga tri ditë më parë si bashkëpunëtor i supergrabitjes në Rinas, është personi i veshur komando që gjendet në pistën e aeroportit, pranë avionit të linjës Tiranë-Vjenë në momentin e grabitjes më



Oltion Veseli

9 prill. Në foton e siguruar nga "GSH", Oltion Veseli është personi i veshur si komando dhe që kërcënon me kallashnikov, ndërsa pranë tij është Admir Murataj, gjithashtu i maskuar. Sipas të dhënave, Veseli në vitet

provuar se personat e arrestuar deri tani në një mënyrë apo tjetër kanë marrë pjesë apo kanë pasur dijeni për megagrabitjen. Bengasi ka pranuar ndër të tjera se është ai, personi që ka modifikuar furgonin me mbishkrimin "Hetimi Tatimor", që u përdor për grabitjen. Gjithashtu, bazuar në emrat që ai ka rrëfyer pritet po ashtu arrestimi i një personi të pestë që ka lidhje me ngjarjen. Alkond Bengasi dje u la në qeli nga Krimet e Rënda në një seancë të zh-

villuar me dyer të mbyllura. 34-vjeçari ka qenë i vetmi nga të arrestuarit që ka dalë para togave të zeza duke e ndarë nga pjesa tjetër. Ndërsa, tre të pranjosurit e tjerë Saimir Çela, Renaldo Sula dhe Oltion Veseli pritet të njihen të martën me masën e sigurisë. Veseli dyshohet se ka pasur rol kryesor në grabitje, pasi dyshohet se ka marrë pjesë direkt në të. Ai gjithashtu dyshohet se është një nga 5 personat që ka hyrë në pistë, megjithatë kjo pritet të konfirmohet.

2000 ka qenë në Jemen me studime dhe më pas ka shkuar në Afganistan. Ndërsa, mësohet se ai më pas është arrestuar nga amerikanët për terrorizëm. Sipas burimeve për "GSH", ai u arrestua në 2005-ën nga tru-

prokuroria dhe policia ka identifikuar edhe të tjerë persona, të cilët janë shpallur në kërkim, por që identiteti i tyre nuk bëhet i ditur. Misteri më i madh për grupin hetimor është vendndodhja e parave, pasi deri tani zyrtarisht nuk është gjetur asnjë shumë.

KUSH JANË KATËR TË ARRESTUARIT

I arrestuari Oltion Veseli nga Fushë-Kruja është kushëri me Ernest e Dash Kupën, të dënuar nga drejtësia për grabitjen e blindave

pat amerikane gjatë një operacioni kundër talebanëve në Afganistan. Veseli u riatdhesua më 25 qershor të 2006. 38-vjeçari Veseli ishte vetëshpallur imam i xhamisë në Krujë. I arrestuari Oltion Veseli nga Fushë-Kruja është kushëri me Ernest e Dash Kupën, të dënuar nga drejtësia për grabitjen e blindave në rrugën e Rinasit në 2017-ën. I arrestuari tjetër, Alkond Bengasi, është kushëri me Klement Çalën, ndërsa dy të tjerët Saimir Çela, Renaldo Sula njihen si njerëzit e tij të besuar. Në kërkim është shpallur edhe vëllai i tij, Eldi Çala. Listës së të kërkuarve i shtohen edhe dy persona të tjerë, emrat e të cilëve nuk bëhen publikë.

në rrugën e Rinasit në 2017. I arrestuari tjetër, Alkond Bengasi, është kushëri me Klement Çalën, ndërsa dy të tjerët Saimir Çela, Renaldo Sula njihen si njerëzit e tij të besuar. Klement Çala, që njihet si personazh tejet i rrezikshëm jeton në arrati që prej 2013-ës. Krahas krimeve të kryera më herët në Shqipëri e Greqi, ai është dyshuar tashmë edhe për grabitjen e 9 prillit dhe mendohet të ketë pasur rol kryesor. Çala njihet për lidhjen e fortë me Admir Muratajn, që

TRANSPORTI I PARAVE

Grabitja Rinas, "Austrian Airlines" do të rinisë transportin e parave. Pas një pezullimi prej dy javësh, "Austrian Airlines" po rishikon mundësinë e rifillimit të transportit të parave nga aeroporti ndërkombëtar i Tiranës drejt Vjenës. Zëdhënësjja e "Austrian Airlines", Tanja Gruber u përgjigj interesit të "News 24" përmes një "e-mail"-i ku tha se nëse gjithçka do të jetë e sigurt, atëherë do të rifillojë shërbimi i transportit kesh të parave. Megjithatë, Gruber nuk dha një datë specifike.



Kapja e autorit të 5-të, Rama:

Rrethi po ngushtohet

TIRANË - Kryeministri Edi Rama ka reaguar në "Twitter" për arrestimet e personave të përfshirë në grabitjen e Rinasit. Rama shkruan se një tjetër person u arrestua nga policia, ndërsa tha se kjo tregon se Policia e Shtetit po godet fuqishëm krimin.

STATUSI I RAMËS:

Arrestohet edhe një autor tjetër i grabitjes së Rinasit, duke e ngushtuar më tej rrethin e keqbërësve falë punës intensive dhe profesionale të Policisë së Shtetit. E cila po provon se ka kaluar në një nivel të ri fuqie goditëse ndaj krimit, duke folur për ditë me rezultate konkrete.

mbeti i vrarë pas grabitjes së dhunshme në aeroportin, pasi janë arratisur së bashku nga burgu i Trikalas në Greqi. Klement Çala nuk është i vetmi nga familja në telashtë mëdha. Në kërkim është shpallur edhe vëllai i tij, Eldi Çala. Listës së të kërkuarve i shtohen edhe dy persona të tjerë, emrat e të cilëve nuk bëhen publikë.

Më 6 maj, seanca e ankimit të Gashit për shkarkimin e saj si prokurore nga KPK

TIRANË

Për herë të dytë, prokurorja e shkarkuar Rovena Gashi kërkoi të ketë përfaqësues ligjore motrën e vet, gjyqtaren Ema Gashi. Kolegji i Posaçëm i Apelit të rrëzoi sërish kërkesën, ndërsa Gashi kërkoi më shumë kohë që motra të japë dorëheqjen si gjyqtare. Prokurorja e shkarkuar Rovena Gashi paraqiti një kërkesë të dytë për t'u përfaqësuar në procesin e apelit të çështjes së saj nga e motra, Ema Gashi, e cila është njëkohësisht gjyqtare. Në seancën e 23 prillit, Kolegji i Posaçëm i Apelit të rrëzoi kërkesën për herë të dytë. Në të dyja rastet, kolegji gjykoj se gjyqtarët dhe prokurorët nuk mund të kryejnë rolin e mbrojtjes. Seanca e së martës u hap me kërkesën e Gashit dhe me tërheqjen e trupës gjyqësore në vendim të ndërmjetëm. Pas refuzimit të dytë, Gashi kërkoi shtyrje të seancës, duke e konsideruar procesin me probleme dhe të parregullt. "Kërkoj minimalisht dy javë kohë. Kërkojmë kohë që Ema të japë dorëheqjen për të bërë të mundur mbrojtjen time", u shpreh ndër të tjera prokurorja Gashi. Ndërkohë, kryesuesja e trupës së KPA, Albana Shytilla, i tërhoqi vëmendjen gjyqtarëve Ema Gashi që të mos i jepte sugjerime motrës së saj, por të zhvendosej në vendet e përcaktuara për

Rovena Gashi kërkon sërish të mbrohet nga motra gjyqtare, refuzohet nga KPA

Vetingu, Eva Gashi do të japë dorëheqjen si gjyqtare për të bërë avokaten e prokurores së shkarkuar



publikun. Trupa u tërhoq sërish për të marrë vendim të ndërmjetëm lidhur me kërkesën për shtyrje, e cila u pranua. Seanca tjetër u përcaktua për datën 6 maj, ora 10:00. Rovena Gashi u sh-

karkua nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit më 25 korrik 2018, por e apeloj vendimin duke argumentuar shkelje. Shkaku kryesor i shkarkimit ishte mosjustifikimi i pasurisë

SHKARKIMI

Rovena Gashi u shkarkua nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit më 25 korrik 2018, por e apeloj vendimin duke argumentuar shkelje. Shkaku kryesor i shkarkimit ishte mosjustifikimi i pasurisë familjare të prokurores Gashi dhe bashkëshortit të saj, prokurorit Dritan Gina. Rovena Gashi dhe Dritan Gina mbanin poste drejtuese në organin e akuzës, gjatë kohës që ky institucion drejtohej nga ish-kryeprokurori Adriatik Llalla.

familjare të prokurores Gashi dhe bashkëshortit të saj, prokurorit Dritan Gina. Rovena Gashi dhe Dritan Gina mbanin poste drejtuese në organin e akuzës, gjatë kohës që ky institucion drejtohej nga ish-kryeprokurori Adriatik Llalla, por të dy u ulën në detyrë menjëherë pas zgjedhjes së Arta Markut në krye të Prokurorisë në dhjetor 2017. Pas uljes në detyrë, Gashi dhe Gina i kundërshtuan vendimet e Markut në gjykatë, duke i cilësuar ato të kundraligjshme. Pretendimet e tyre u rrëzuan respektivisht nga Gjykata e Durrësit dhe Gjykata Administrative e Tiranës, duke lënë në fuqi vendimet e kryeprokurores. Po ashtu, Kolegji i Posaçëm i Apelit

rrëzoi një kërkesë të çiftit kundër vendimit për pezullimin e tyre. Megjithatë, pasi Gashi ishte shkarkuar nga KPK-ja, Gjykata Administrative e Apelit rrëzoi vendimin e Markut për pezullimin e tyre nga detyra. Gashi dhe Gina po ashtu ishin nën hetim për "fshehje të pasurisë" dhe ishin pezulluar me urdhër të prokurores së përgjithshme të Përkohshme, Arta Marku.

Çifti i cilësoi akuzat si hakmarrje personale të Markut, pas padive që ata bënë më herët kundër saj. BIRN mësoi se më kërkesë të Prokurorisë së Fierit dhe me miratimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, çështja penale ndaj bashkëshortëve Gina-Gashi është pushuar. / Reporter.al



NJOFTIMI I ANKANDIT

- Autoriteti Shitës:** Albpetrol Sha Patos, Rruga Fier – Patos km 7.
- Data e zhvillimit të ankandit:** 03.05.2019, ora 11:00.
- Lloji i Procedurës të ankandit:** Procedure e hapur.
- Objekti i Shitjes:** Shitje nafte brut, sasia 75 101 ton.
- Afati i evadimit:** 270 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes:** Shitje e nafte brut, sasia 75 101 ton.

7. Vlera fillestare:

Ne kushtet FOB:

Çmimi minimal fillestar per njësi është:

75.27 % e Çmimit Brent + K

Në pikat e lëvrim:

Çmimi minimal fillestar për njësi është:

75.27 % e Çmimit Brent – 2.97 USD/bbl + K

- 75.27 % është koeficienti i cili përfaqëson karakteristikat mesatare të naftës (peshat specifike, aciditeti i naftës, % e squfurit).
- Brent është çmimi në \$/bbl i Brent i Platts, i publikuar në Buletinën e Prokurimit Publik.
- 2.97 USD/bbl kosto mesatare totale (transport, magazinim, stokim, analizim produkti, sigurim).

- K- është vlera \$/bbl e ofruar nga ofertuesi mbi çmimin minimal shitjes të përllogaritur nga formula (Ke"0).

- Vendndodhja e naftës brut: Albpetrol sha Patos:** Ne pikat e levrimt Stacioni Usoje, Stacioni Visoke, Stacioni Gorisht, Stacioni Zharrez, Stacioni Kuçovë, Stacioni Amonice.

- Vendi i zhvillimit të ankandit:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati II, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.

- Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:** në zyrën e protokollit Kati 1 tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, datë 03.05.2019, ora 11:00.

- Data e hapjes së ofertave:** datë 03.05.2019, ora 11:00, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Rruga Abdi Toptani Nr. 1, Kati II, Salla e Mbledhjeve, Tiranë.

12. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit shitës me paraqitjen e një kërkesë me shkrim ose në faqen zyrtare të "Albpetrol" sha www.albpetrol.al dhe në faqen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë www.infrastruktura.gov.al.

Dokumente me pagesë:

Po Jo X

- Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, përpara datës dhe orës së zhvillimit të ankandit, në vendin e përcaktuar në dokumentat e ankandit.

Pas një pezullimi prej dy javësh, 'Austrian Airlines' po rishikon mundësinë e rifillimit të transportit të parave nga aeroporti ndërkombëtar i Tiranës drejt Vjenës. Zëdhënësja e 'Austrian Airlines', Tanja Gruber u përgjigj interesit të News24 përmes një e-maili ku tha se, nëse gjithçka do të jetë e sig-



Grabitja në Rinas/"Austrian Airlines" do rinisë transportin e parave

urt, atëherë do të rifillojë shërbimi i transportit kesh të parave. Megjithatë Gruber nuk dha një datë specifike. "Pas grabitjes së avionit tonë OS848 më datë 9 prill në aeroportin e Tiranës, 'Austrian Airlines' pezulloi

transportin e ngarkesave me vlerë si një masë emergjente. Që nga grabitja jemi duke u marrë me situatën. Ne po planifikojmë të rifillojmë transportin e ngarkesave me vlerë, gjithsesi sot nuk mund t'u konfirmojmë një

datë të caktuar. Në ditët në vijim do të bëhet një inspektim i gjithë departamenteve. Vetëm pas këtij inspektimi do të marrim një vendim për të rifilluar transportin e vlerave", u përgjigj Gruber.

Guvernatori i BSH-së: Destabiliteti politik rrit rreziqet në ekonomi

Grabitja në Rinas/ Sejko: Dëmtojnë të gjithë ekonominë

Në 2018 punësimi në ekonomi u rrit me 1.6%

Grabitja e parave në Rinas nuk ka dëmtuar vetëm sistemin bankar, por gjithë ekonominë e vendit. Ky është vlerësimi i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë Gent Sejko, i cili u përgjigj interesit të "Banka e Shqipërisë si institucion licencues është përgjegjës për kërkesat minimale që bankat kanë për ambientet e tyre pra në objektet e tyre. Lidhur me transportin e vlerave monetare ka një udhëzim të Ministrisë së Brendshme, e cila si rregullore është forcuar. Ngjarja e fundit ka ndodhur në ambientet e aeroportit dhe jo gjatë transportimit. Masa e marra janë ndryshimet rregullative për këtë rregullore që ne e kemi përforcuar dhe sigurisht që përgjegjësia direkte e jona është për të monitoruar dhe mbikëqyrur zbatimin e kërkesave të sigurisë së bankave në ambientet e tyre." - u shpreh Sejko ndërsa shtoi se bankat janë të mirëkapitalizuara dhe janë të afta për të përballuar situata financiare qoftë edhe nga këto humbje apo goditje. Ai sqaroi se Banka e Shqipërisë është institucion licencues, dhe si e tillë është përgjegjës për kërkesat minimale që bankat kanë për ruajtjen e ambienteve të tyre, pra në objektet e tyre. Sejko sqaroi se lidhur me transportin e vlerave monetare ka një udhëzim i Ministrisë së Brendshme që rregullon transportin e vlerave monetare në aspektin e sigurisë, rregullore e cila është forcuar dhe tashmë është në fuqi.



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko

që ka destabiliteti politik në vend. Ai tha se, politika monetare ruajt krahnun lehtësues më 2018, teksa ekonomia shqiptare pati një ecuri pozitive për vitin 2018. Ritmi i rritjes ekonomike u përsëritua me 4.1 për qind gjatë

vitit 2018. Rritja ekonomike pati bazë të gjerë, ajo pasqyroi kontribute pozitive nga zgerjimi i konsumit familjar i investimeve dhe eksporteve. Punësimi në ekonomi u rrit me 1.6% ndërsa norma e papunësisë u ul në 12.3%. Deficiti i llogarisë koherente zbriti në 6.7% e PBB-së gjatë 2018 nga 7.5% në 2017. Deficiti buxhetor dhe borxhi publik vijuan rënien, teksa treguesit kryesor të shëndetit të sektorit bankar shënuan uljen. Inflacioni vjetor shënoi 2.20%

Sistemi bankar është forcuar

Blerjet e kanë balancuar sektorin, nxisin konkurrencën

Banka e Shqipërisë vlerëson se viti 2018 solli përmirësime të mëtejshme në veprimtarinë e sistemit bankar. Në raportin e tij para komisionit të Ekonomisë dhe Financave, Guvernatori Sejko tha se aftësia e këtij sektori për të përballuar rreziqet është e lartë. Kapitalizimi dhe likuiditeti janë në nivele më se të kënaqshme, ndërsa raporti i kredive me probleme ka zbritur në nivelet më të ulëta prej pothuajse një deкаде. Guvernatori u shpreh optimist edhe për sa i takon procesit të ristrukturimit të bankave. Ai theksoi se procesi i shitblerjes ka qenë i balancuar, duke krijuar disa banka të përmasave të përafërta brenda sistemit. Kjo pritet të nxisë konkurrencën dhe të rrisë ofertën për kredi në ekonominë shqiptare.

in njëte më nivelin e vitit 2017 dhe nën objektivin e Bankës prej 3%. Monekda vendase është forcuar tre vitet e fundit i dilancit tregtar me jashtë, nivelet e larta të investimeve të huaja, redukti-

mi i primeve të rrezikut në tregjet e brendshëm, tha Sejko. Megjithatë përtej këtyre efekteve, kursi i këmbimit ishte subjekt i disa goditjeve në gjysmën e parë të vitit 2018. Këto goditje sollën zhbhalancimin e përkohshëm të kërkesës dhe ofertës për valutë dhe ndikuan në krijimin e pritjeve për forcim të mëtejshëm të kursit, duke u shoqëruar edhe me një ndryshim e sjelljes së operatorëve të ekonomisë. Ata incian një sjellje të shpejtë të forcimit të lekut në kursin e këmbimit dhe u shoqëruan me rregullim të tregut të brendshëm valutë, argumentoi Guvernatori para deputeteve. Banka e Shqipërisë në lidhje me këto zhvillime reagoi duke ulur normën bazë nga 1.25% në 1% dhe aplikoi ndërhyrje në tregun valutë duke normalizuar luhatjet në kurdin e këmbimit. Kredia në lekë në sektorin privat u rrit me 6.7% gjatë vitit 2018. Letësimi interesave për kredinë në lekë më 5.6 pikë përqindje nga 2011 u ka kursyer shqiptare 15 miliardë lekë në vit. Guvernatori tha se, politika monetare ka mbështetur stabilitetin financiar në vend, duke ndikuar në rritjen e kërkesës për mallra dhe shërbime. Ka ndihmuar në uljen e kostove të borxhit dhe në përmirësimin e aftësive paguese të familjeve shqiptare.

"Kriptomonedhat", Arben Ahmetaj apel BSH-së: Të edukohen qytetarët

Kreu i Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave, Arben Ahmetaj tha se Bankës së Shqipërisë dhe të gjitha institucioneve të tjera iu duhet më shumë punë për të ndërgjegjësuar qytetarët për paratë elektronike apo siç njihet ndryshe në terminologji si "kriptomonedha". Këtë deklaram Ahmetaj e bëri gjatë mbledhjes në Komisionin të Ekonomisë dhe Financave, ku Guvernatori Gent Sejko prezantoi raportin dhe punën e bankës gjatë vitit 2018. "Kriptomonedha është një realitet global dhe është detyrë e Bankës së Sh-

qipërisë dhe institucioneve të tjera për edukim të qytetarëve"-tha ai. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe njëkohësisht Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës të saj, Gent Sejko ka prezantuar para Komisionit të Ekonomisë dhe Financave raportin e BSH-së për vitin 2018. Ai tha se viti që lamë pas ka

qenë një vit i suksesshëm për ekonominë shqiptare, ndërsa tregoi se elementet e treguesit të sistemit bankar kanë kontribuar në mënyrë të shëndetshme në ekonomi. Guvernatori Sejko pohoi se Banka që ai drejton ka përmbytur me rigozoritet të gjitha këshillat e Kuvendit të Republikës.



Kreu i Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave, Arben Ahmetaj

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përmbartimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të I (Parë), për shënjën e pasurisë së paluajtshme - Garazh, me sip. 96 m², Zona Kadastrale: 2640, Numri i Pasurisë: 199/32-G3, Vol. 45, Fqaje 169, ndodhur në Linzë Dajç, Tiranë, në pronësi të Shoqërisë "AGL" sipë e identifikuar me NIFIT 371702004M, Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën 1,893,120 (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet) LEKE.

Ankandi do të zhvillohet më datë 26.04.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbartimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 131, Ap. 1, Tiranë, nr.telëfon 042320227, email: elvinth@hotmail.com.

Ankandi të publikohet nga data 22.04.2019 deri më 26.04.2019

Shitje me Ankand të Pare nga Studio Përmbartimore L.D.C

- Nr. pasurie 50/1, ZK Virua, vol 1, fq 27, Tullal me sip. 240.47 m² + ndërtesa me sip. 240.47 m², Regjistruar në ZVRPP Gjirrokaster në emër të Fatos Çela. Çmimi fillestar për shitje është 3.445.600 Leke.

- Nr. pasurie 190/84, ZK 2647, vol 2, fq 247, Tullal me sip. 300 m² + ndërtesa një katëshe me sip. 88 m², Regjistruar në ZVRPP Tepelene në emër të Votim Çela, Çmimi fillestar për shitje është 1.064.000 Leke.

Data e shpalljes 09.04.2019
Data e zhvillimit 08.05.2019 deri në orën 16.00
Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Përmbartimore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

EDUKIMI EKONOMIK INTERVISTA

Pedagogu në "Luarasi" sjell analizën e detajuar mbi informimin e qytetarëve

Prof. Asoc dr. Stefan Qirici: Ku bazohet ecuria e ardhshme e ekonomisë shqiptare

"Pse duhet të investojmë fuqishëm në edukimin ekonomik"

Voltiza Duro

Qëllimi i edukimit ekonomik është të përmirësojë kuptimin tonë të botës dhe mjedisit ekonomik në të cilën ne jetojmë. Pa këtë kuptim, ne si qytetarë jemi shpesh të hutuar dhe të paafat për të identifikuar, analizuar dhe interpretuar me sukses aspektet e ndryshme të jetës ekonomike, të cilat janë aq të shumta rreth nesh dhe ndikojnë tek ne në mënyra të ndryshme. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", prof. asoc. Dr. Stefan Qirici, ekspert ekonomie e njëkohësisht pedagog në universitetin "Luarasi" tregon rëndësinë e edukimit ekonomik dhe format që mund të përdoren për t'u dhënë informacionin e duhur qytetarëve. Sipas tij, aspektet e jetës ekonomike në disa raste janë të thjeshta dhe nuk kërkojnë të zotërosh shumë njohuri, përveç njohurive bazë të funksionimit të ekonomisë, por në disa raste të tjera janë të ndërlikuara dhe kërkojnë të zotërosh njohuri ekonomike të specializuara.

Pse është i nevojshëm edukimi ekonomik në një shoqëri?

Edukimi ekonomik është vital për ecurinë e ardhshme të ekonomisë së vendit. Prandaj mendoj se është imperative, është domosdoshmëri që të promovojmë edukimin ekonomik të qytetarëve tanë dhe të shpjegojmë në veçanti se pse njohuritë bazë ekonomike duhet t'i përvetësojë çdo anëtar i shoqërisë. Ky aspekt bëhet akoma më i domosdoshëm në kushtet e transformimeve të mëdha dhe zhvillimeve komplekse ekonomike dhe politike që kanë ndodhur dhe po ndo-



Prof. Asoc dr. Stefan Qirici

dhin gjatë periudhës së tranzicionit në vendin tonë nga një sistem diktatorial në demokraci, nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e tregut, të cilat edhe pse kanë kaluar 28 vite nuk po i duket fundi. Edukimi ekonomik i popullsisë, i qytetarëve të vendit, është jetik për zhvillimet aktuale dhe zhvillimet e ardhshme të ekonomisë së vendit tonë.

Si mund të realizohet ky edukim?

Edukimi ekonomik i qytetarëve mund të realizohet në forma dhe metoda të ndryshme. Edukimi ekonomik, fillon që në bankat e shkollës, me programe dhe lëndë të veçanta, edukimi ekonomik i specializuar thellohet në shkollat e larta universitare. Edukimi ekonomik mund të realizohet edhe nëpërmjet trajnimeve dhe ritrajnimeve të vazhdueshme në vendin e punës. Në këtë këndvështrim edukimi ekonomik është dhe duhet të jetë aspekt i të mësuarit gjatë gjithë jetës. Edhe media e shkruar apo e folur ka dhe luan një rol shumë të madh në këtë fushë, e cila sipas mendimit tim nuk po e luan si duhet këtë rol kaq të rëndësishëm në edukimin

ekonomi të qytetarëve. Në tërë këtë periudhë tranzicioni, edhe sot e kësaj dite, fatkeqësisht mbisundese në mediat tona mbetet kronika e zezë, lajmet dhe pasqyrimi i veprimtarive të politikës, shkrimet në "Facebook" apo "Twitter" të politikaneve, kronikat rozë të të ashtuquajtura "vipa", a thua se tërë bota vërtitet dhe rreth këtyre dukurive dhe se mirëqenia jonë përmirësohet prej këtyre lajmeve!

Sipas mendimit tuaj



INVESTIMI

Parë në këtë aspekt, në të gjithë format e realizimit të tij, edukimi ekonomik u jep anëtarëve të shoqërisë, qytetarëve të vendit, njohuritë e domosdoshme për të qenë qytetarë aktivë në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të vendit. Ai i fuqizon qytetarët, duke i bërë ata më aktivë, më pjesëmarrës në diskutime dhe debate ekonomike, më të vetëdijshëm për veprimet që kryejnë dhe për përgjegjësitë që marrin, duke u dhënë atyre njohuri dhe mjete për të përmirësuar mirëqenien e tyre ekonomike.

pse edukimi ekonomik konsiderohet si një investim i vlefshëm?

Parë në këtë aspekt, në të gjithë format e realizim-



EDUKIMI EKONOMIK

Edukimi ekonomik është vital për ecurinë e ardhshme të ekonomisë së vendit. Prandaj mendoj se është imperative, është domosdoshmëri që të promovojmë edukimin ekonomik të qytetarëve tanë dhe të shpjegojmë në veçanti se pse njohuritë bazë ekonomike duhet t'i përvetësojë çdo anëtar i shoqërisë.

it të tij, edukimi ekonomik u jep anëtarëve të shoqërisë, qytetarëve të vendit, njohuritë e domosdoshme për të qenë qyteta-

rë aktivë në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të vendit. Ai i fuqizon qytetarët, duke i bërë ata më aktivë, më pjesëmarrës në diskutime dhe debate ekonomike, më të vetëdijshëm për veprimet që kryejnë dhe për përgjegjësitë që marrin, duke u dhënë atyre njohuri dhe mjete për të përmirësuar mirëqenien e tyre ekonomike. Është kjo arsyeja që edukimi ekonomik i qytetarëve, nga ky këndvështrim, duhet të konsiderohet si një nga investimet më të vlefshme që mund të bëjmë për të realizuar dy objektiva kryesore: së pari, nga këndvështrimi shoqëror, për të zhvilluar, forcuar ekonominë e vendit tonë dhe për të garantuar qëndrueshmërinë dhe ardhmërinë e saj dhe së dyti, nga këndvështrimi individual, për të garantu-



manipulueshëm nga forca të caktuara të çfarëdo lloji. Si të tillë ata janë turma të verbra, janë si fiçe bari që lëkundën dhe shkojnë andej nga fryn era!

Megjithatë, përvoja ideale edukative qytetare nuk është thjesht një transferim i njohurive se në rastin nga mësuesi tek nxënësi. Për të prodhuar qytetarë të angazhuar në mënyrë aktive, edukimi qytetar duhet, gjithashtu, të nxisë zhvillimin dhe përdorimin e aftësive të angazhimit qytetar. Këto përfshijnë aftësi intelektuale të tilla si të menduarit kritik dhe zgjidhja e problemeve, si dhe aftësitë pjesëmarrëse të tilla si diskutimi rreth çështjeve publike, komunikimi me grupe të ndryshme njerëzish si dhe pjesëmarrje dhe ndikim në hartimin e politikave. Edukimi qytetar duhet të sigurojë një kontekst të strukturuar për të stimuluar dhe për të nxitur në vazhdimësi këto aftësi.

Duhet të theksojmë se, qytetari i edukuar i angazhuar në mënyrë aktive në demokraci duhet të zotërojë disa vlera të mbajtura dhe të ruajtura me sinqeritet. Vlera të tilla janë e qëndrimi tolerant, ndershmëria, përgjegjësia, transparenca, respekti dhe të tjera tipare të ngjashme. Pa zotëruar këto vlera të tilla as Kushtetuta, as institucionet, as ligjet as institucionet më të mira nuk mund të sjellin një demokraci të qëndrueshme dhe të konsoliduar.

Përvoja edukative qytetare nuk duhet të mësojë vetëm për këto vlera, por, gjithashtu, duhet t'i demonstrojë ato në mënyrë aktive përmes një mjedisi demokratike të ndërtuar me kujdes. Edukimi i efektshëm qytetar, pra, mëson në mënyrë eksplicite, të drejtë

përdrejtë, njohuritë, shkathhtësitë dhe vlerat që behohen të nevojshme dhe të domosdoshme për qytetari demokratike.

Profesor, cilat janë disa nga zgjidhjet që ju ofroni për zhvillimin e një shoqërie demokratike?

Theksojmë se njohja e institucioneve dhe parimeve demokratike dhe aftësitë për të marrë pjesë aktive në një demokraci janë dy elemente të qartë-

sisht të dallueshme nga njëri-tjetri. Në raportet midis tyre më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet zhvillimit të aftësive të qytetarëve për pjesëmarrje aktive në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të vendit, por kjo nuk do të thotë se njohja e institucioneve dhe parimeve demokratike të ndërtimit dhe zhvillimit të shoqërisë janë më pak të rëndësishme. Për ta bërë këtë,

duhet që në vend të krijojmë një mjedis demokratike bashkëpunues që u krijon mundësi qytetarëve që të praktikojnë dhe të shpalosin plotësisht aftësitë e nevojshme për pjesëmarrje demokratike në shoqëri.

Eshtë e lehtë të kundërshtosh, të braktisësh parlamentin, të bësh indiferentin, të mos marrësh pjesë në debat, të mos japësh alternativa të mendimit, të mos respektosh mendimin e tjetrit, të imponosh qëndrime dhe mendime. Kjo mënyrë sjelljeje qytetare nuk na duhet, nuk ka asnjë vlerë pozitive për një shoqëri demokratike.

Në vend të kundërshtimit të ofrojmë bashkëpunimin, në vend të braktisjes duhet pjesëmarrja aktive me alternativa zhvillimore, në vend të indiferentit dhe mospjesëmarrjes në debat duhet angazhim total, qëndrim kritik dhe pjesëmarrje me ide të reja në debat, duhet respekt për mendimin e tjetrit, tolerancë dhe transparencë në qëndrime dhe në mendime. Këto vlera duhet t'i edukojmë t'u ruajmë e zhvillojmë në shoqërinë demokratike që po ndërtojmë.

NDIKIMI I PROCESIT

Objektivi kryesor i edukimit ekonomik të qytetarëve është që të krijojë të formojë atë qytetar, i cili merr pjesë aktive dhe angazhohet i vetëdijshëm në të gjitha proceset demokratike të jetës së vendit. Në një nivel konceptual, këta qytetarë të tillë janë të informuar për çështjet ekonomike, politike shoqërore dhe kuptojnë ekuilibrin midis interesave të tyre individuale dhe të shoqërisë apo të mirës së përbashkët.


ar dhe rritur nivelin e mirëqenies të anëtarëve të shoqërisë.

Sa ndikim ka ky proces në zhvillimin e një shteti demokratik?

Objektivi kryesor i edukimit ekonomik të qytetarëve është që të krijojë të formojë atë qytetar, i cili merr pjesë aktive dhe angazhohet i vetëdijshëm në të gjitha proceset demokratike të jetës së vendit. Në një nivel konceptual, këta qytetarë të tillë janë të informuar për çështjet ekonomike, politike shoqërore dhe kuptojnë ekuilibrin midis interesave të tyre individuale dhe të shoqërisë apo të mirës së përbashkët. Praktikisht, ata, gjithashtu, demonstrojnë pjesëmarrjen aktive të përditshme në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore duke kontribuar në të mirën e komunitetit dhe shoqërisë së tyre duke vlerësuar dhe respektuar të drejtat dhe detyrat e veta gjithashtu edhe të tjerëve.

Në gjithë këtë "lumë" informacioni, sa mund të përfitojë shoqëria dhe a duhet të ketë një përzgjedhje të këtij informacioni?

Duhet të theksojmë se njohuritë për një qëllim të caktuar (për shembull njohuritë ekonomike) dhe jo masa e madhe e informacionit është komponenti kyç që kontribuon në formimin e qytetarit të angazhuar. Për sa i përket masës së informacionit ai derdhet si lume çdo ditë nga mediat tonë por, pyetja shtrohet a është ai informacion në sasi dhe në cilësi që na duhet dhe që i shërben një qëllimi të caktuar nga i cili përfiton individi dhe shoqëria? Qytetarët që nuk zotërojnë as njohuritë më elementare se si funksionon ekonomisë, si është ndërtuar dhe funksionon struktura apo sistemi politik i shoqërisë kanë më pak gjasa të jenë të angazhuar në mënyrë aktive, por nga ana tjetër ata janë më lehtë të



ProSEED: Announcement

Social Initiatives – Call for Expressions of Interest and submission of Proposals

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED), implemented on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development, under the component of Social Initiatives seeks in partnership with local CSOs to foster the inclusion perspectives of marginalized youth in employment and/or education.

In this respect, the programme is conducting a Call for (i) Expressions of Interest and (ii) submission of project Proposals from **19 April – 10 May 2019** at giz-albanien@giz.de.

The proposals that are to be selected through this call shall receive financial support ranging up to 50,000 EURO (equivalent in ALL).

Main Steps of the Procedure:

First step: (i) Expressions of Interest
All interested CSO at least with 2 years of experience implementing projects in the field of youth empowerment shall write to giz-albanien@giz.de with the following text:

"We herewith declare our interest to participate in the 3rd Call for Proposals, organized by the GIZ ProSEED programme under the Social Initiatives Component. Please send us the respective Application Package."

Second Step: (ii) Submission of Application.
Upon receipt of the application package the CSO should consult the Application Guidelines to prepare their project proposals for all related eligibility criteria. The Application Guidelines (a separate document) can be downloaded from the ProSEED Facebook page. Deadline for the submission of application is **10 of May 2019**.
The application package must be submitted electronically in English at giz-albanien@giz.de. Applications submitted in hardcopies shall not be taken into consideration. (Applying CSOs must take care to submit the budget in excel as a separate template and not merge it with the project description).

Third Step: (iii) Assessment and Evaluation of Proposals
Upon submission of the proposals by the CSOs the assessment and evaluation procedure shall be implemented as described in the Application Guidelines. For more information and the timeline of procedure please consult the Application Guidelines of this 3rd Call for Proposals.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to express your interest and receive the application package.

For further questions contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period **19 April – 10 May 2019**.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 24 Prill 2019

GAZETA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela Aliaj

"BULEVARDI POLITIK"

- Partia e re e Patozit u themelua në një studio muzikore
- Rama i veshur me "kanabis", Berisha: Shumë premtues...
- Dita e fundit e seancës, surprizon eurodeputeti sloven
- Trump me origjinë shqiptare, nip i Jerliut dhe Sevdijes




E lënduar nga dashuria?
Rrëfëhet Fjoralba Ponari:
Pendohem kur mendoj vuajtjen



Së shpejti dasmë!
Boksieri shqiptar
martohet me modelen



Nga Klajda Gjoshja te Jorida
Tabaku, kush do të bëhet prind



Së shpejti nënë!
Politikanet që janë në
pritje të ëmbël

Djalë apo vajzë? Si e zbuluan surprizën femrat e njohura

Nga Klajda Gjoshja te Jorida Tabaku, kush do të bëhet prind

Së shpejti nënë! Politikanet që janë në pritje të ëmbël

Djalë apo vajzë? Si e zbuluan surprizën femrat e njohura

Pamela Aliaj

Lajmi më i bukur që mund të marrë një femër është se së shpejti do të bëhet nënë! Një emociion i cili nuk ka sesi të shpjegohet, përveçse nga ato që e kanë përjetuar. Së fundmi duket se janë disa nga femrat e njohura politikanet, të cilat do të përjetojnë këtë ndjesi unike. Disa prej tyre i ka zbuluar vetë "Gazeta Shqiptare", disa të tjera vendosën ta japin vetë lajmin e bukur. Më poshtë listojmë disa prej tyre që së shpejti do të bëhen nëna.

JONA DERVISHI

Kjo bën përjashtim nga lista jonë e politikanëve por s'kishim si të mos e përfshijmë. Jona Dervishi njihet si bukurshja, që për shumë kohë ishte zëdhënësjë e FSHF-së. Bëhet me dije se ish-zëdhënësjë është në muajin e shtatë të shtatzënisë. "Gazeta Shqiptare" ka mësuar se ajo dhe partneri i saj do të bëhen prindër të një vajze pas pak kohe. Shumë e pranishe me rrjetet sociale, Jona ka zgjedhur ta mbajë të fshehtë këtë lajm, të paktën deri ditën e sotme. Ky lajm e gjen çiftin më të lumtur se kurrë më parë. Burimet thonë se Jona ka një lidhje të konsoliduar dhe një bashkëjetesë prej mëse dy vitesh, ndaj dhe kjo shtatzëni është shumë prituro nga të dy. Ne nuk na mbetet gjë tjetër veç se t'i urojmë Jonës shtatzëni të mbarë dhe si thotë populli, "Tjetër herë me djalë".

KLAJDA GJOSHA


Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integritet, Monika Kryemadhi, zbuloi sekretin se Klajda Gjoshja do të bëhet nënë për herë të dytë. Siç "Gazeta Shqiptare" raportoi në muajin shkurt, Kryemadhi ishte e ftuar tek Artur Zheji për folur për protestën, kur ndër të tjera u shpreh: "Klajda Gjoshja ishte dhunuese? Që është dhe shtatzënë". Lajmi u përhap me shpejtësi, por ish-deputetja preferoi heshtjen, derisa ajo të zgjidhte vetë momentin kur do e ndante me publikun lajmin e bukur. E ftuar mbrëmjen e djeshme në "Provokacija", ish-ministrja e Integritetit jo vetëm pranoi lajmin, por edhe zbuloi se shumë shpejt në familjen e saj do të vijë në jetë një vajzë. "Njeriu duhet të dijë të ndajë momente të jetës private me këtë lumturi që unë po përjetoj së bashku me familjen time, për të pritur së shpejti një vajzë dhe pjesën tjetër, që është ajo e profesionit. Unë jam pjesë e një profesioni që është shumë agresiv shpeshherë. Megjithatë, e gjithë kjo situatë do të sjellë një dritë jeshile në fund të tunelit", u



Jorida Tabaku



Elda Hoti



Ina Zhupa

shpreh Gjoshja. Gjithashtu, ish-deputetja e LSI-së ka një djalë, i cili quhet Luis.

JORIDA TABAKU

Ish-deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, e ftuar në studion e lajmeve në "News 24" ka zbuluar seksin e fëmijës që pret të sjellë në jetë. E pyetur në studion e lajmeve rreth pritjes së ëmbël, ish-deputetja ka zbuluar se pas vajzave binjake, do të sjellë në jetë një djalë.

Kjo është shtatzënia e dytë për ish-deputetën demokratike. Jorida Tabaku njihet si një ndër femrat më sharmante në politikën shqiptare. Gjithnjë e matur dhe duke ruajtur feminalitetin, Jorida ia ka dalë të jetë një ndër politikanet më të dashura për shqiptarët.

ELDA HOTI

Deputetja e re është bërë nënë për herë të dytë ditën e djeshme.

Elda Hoti u fut vetëm pak kohë më parë, duke marrë mandatin e lënë nga Viktor Tushaj. Por, duket se asaj s'është do t'i duhet të shkëputet për pak kohë nga politika, për të shijuar mësimin për të dytën herë. Ashtu siç duket edhe në foton e publikuar prej saj, Elda ka sjellë në jetë Davisin e vogël. Të shumtë kanë qenë dhuratat dhe urimet adresuar deputetes.

INA ZHUPA

Zëdhënësjë e Partisë Demokratike

ka uruar Pashkët të dielën që kaloi. Por, ky urim i saj është edhe më i veçantë, pasi ajo ka postuar një foto me barkun e rrumbullakosur, duke i uruar Pashkët bashkë me djalin që pritet të vijë në jetë së shpejti.

STATUSI I INA ZHUPES

"Gëzuar Pashkën miq, nga unë dhe im bir! Bekimi më i madh në jetë është familja. Ndaj ju uroj të gjithëve familjarisht mirësi, dashuri, shëndet dhe begati!"



Jona Dervishi




Klajda Gjoshja

Robin Krasniqi, boksieri i njohur shqiptar prej vitesh tashmë është i lidhur me modelen sexy Heidi Lushtaku, ndërkohë së fundmi ata kanë shprehur dëshirën për ta kaluar lidhjen e tyre në një tjetër nivel. Një dasmë është në horizont dhe dyshja në fjalë ka pohuar se së shpejti do të kurorëzojë dashurinë në martesë.




Gjatë një interviste për revistën "Who", Heidi dhe Robin kanë folur për romancën e tyre disavjeçare dhe për planet që kanë për karrierën dhe lidhjen e tyre. "Për momentin nuk kemi filluar asnjë organizim. I kemi disa ide për vendin dhe dasmën që do jetë moderne, por asgjë nuk është konkrete. Tani jemi shumë të përqendruar për ndeshjen e 11 majit të Robin. Përgatitjet e Robin na marrin gjithmonë 3 muaj dhe është një organizim i madh. Familja është e ardhmja e një çifti të lumtur. Të dy ne vijmë nga familje të mëdha", ka pohuar Heidi. Në vijim, Lushtaku ka deklaruar se edhe ajo, edhe partneri i saj vijnë nga familje të mëdha dhe se qëllimi i tyre është që në një të ardhme të afërt të kenë një familje që gëzon shëndet të plotë dhe që është e lumtur.



Së shpejti dasmë! Boksieri shqiptar martohet me modelen

Noizy është tepër aktiv në llogarinë në "Instagram", ku publikon momente nga përditshmëria e tij. Ndër të tjera, aty nuk mungojnë edhe thëniet domethënëse që i drejtohen një audience të caktuar. Së fundmi, reperi ka shkruar një mesazh, i cili u drejtohet ndjekësve të tij, por jo vetëm. "Mos e gjykoni të kaluarën time, nuk jetoj më atje!", - shkruan Noizy, pa sqaruar detaje më të hollësishme. Rikujtojmë se thënie të shkurtra të këtij lloji, reperi ka postuar shpesh kohët e fundit. Vetëm para pak ditësh ai publikoi një foto të tijen, krah së cilës kishte diçka për t'u thënë të gjithë mesuesve të tij, të cilët dikur e kanë ngelur në klasë. "Përsëhendes mesuesit që më ngelën në shkollë!", - shkruante Noizy, i cili për arsye që nuk dihen e ka fshirë postimin nga llogaria e tij.



Noizy habit me mesazhin: Mos e gjykoni të kaluarën time!

Në dhjetor të vitit të kaluar, çifti Eni Jani dhe Genc Fuga rrëmbyen kupën e spektaklit të famshëm "Dance with me". Të ftuar në emisionin "Trokit", ata kanë bërë të qartë që edhe pse fituan, nuk patën një shpërblim monetar. "Asnjëherë nuk është thënë që në fund të garës, fituesi do të marrë lekë. Ne kemi marrë 1 milion lekë të vjetra sa herë kemi fituar kupën", u shpreh Eni. Gjithsej ata fituan 4 kupa gjatë kompeticionit, pra arritën të sigurojnë 4 milionë lekë të vjetra. "E kam shijuar dhe jam kënaqur jashtë mase atë periudhë sidomos periudhën e provave, sepse mua më pëlqen shumë kërcimi, por nuk është thënë kurrë që ka një x shifer për fituesin. Nuk më duket e drejtë fare, madje e kam kundërshtuar. Por kemi rënë dakord me ato kushte, sepse këtë gjë nuk e morëm vesh rrugës, për të qenë të drejtë. Hymë për ta shijuar".



Fituan "Dance with me", Eni Jani dhe Genc Fuga tregojnë si qëndron e vërteta e lekëve

Ajo është shumë hermetike për jetën e saj private, por herë pas here zgjedh të flasë me ndjekësit e saj. Së fundmi, njëri prej tyre e ka pyetur moderatoren e "E Diell", Fjoralba Ponari, nëse ka ndonjë peng nga dashuria. "Pëndohem kur mendoj vuajtjen që kam kaluar, por jo eksperiencën, sepse më ka rritur si njeri!", - përgjigjet Fjoralba, duke lënë të kuptojmë se një histori dashurie nuk ka shkuar siç ajo do të donte. Përsa i përket statusit të tanishëm, në dhjetor të vitit të shkuar, Fjoralba postoi një foto ku shfaqej bashkë me partnerin e saj, fytyra e të cilit ishte mbuluar nga një ikonë në formë zemre. Ashtu të buzëqeshur të dy, mbase përgjigja e mësipërme i referohet të shkuarës së Fjoralbës.



E lënduar nga dashuria? Rrëfëhet Fjoralba Ponari: Pëndohem kur mendoj vuajtjen

BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

POLITIK

Dita e fundit e seancës, surprizon eurodeputeti sloven

Eurodeputeti sloven Lojze Peterle gjeti një mënyrë të veçantë për të përshëndetur kolegët parlamentarë në seancën e fundit të kësaj legjislature të Parlamentit Europian. Peterle luajti me Harmonikë "Oden e Gëzimit" të Bethovenit, e njohur edhe si himni i Bashkimit Europian. Te nderuar kolege. Ky është vendimi ynë i fundit në këtë parlament dhe unë do doja t'ju falënderoja për 5 vitet e bashkimit dhe diversitetit. Eshë përgjegjës e jona të mbajmë të bashkuar Europën. Të rindërtojmë Notre Damin dhe gëzuar Pashkët. Peterle, i cili ka qenë edhe kryeministër i Sllovenisë iu bëri thirrje vendeve anëtare të unionit të punojnë për ta mbajtur të bashkuar Europën. Zgjedhjet për Parlamentin Europian zhvillohen nga 23 deri në 26 Maj.



Partia e re e Patozit u themelua në një studio muzikore

Ditën e djeshme, një pjesë e demokratëve të pakënaqur me Partinë

Demokratike zyrtariauan në Gjakatën e Tiranës regjistrimin e partisë më të re në vend, të quajtur "Bindja Demokratike". Por, para se të dilnin në këtë vendim, kreu i kësaj nisme politike, Astrit Patozi mbledhi në një takim që zgjati për afro 3 orë disa nga bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, ku dhe ranë dakord për formalizimin e kësaj lëvizjeje politike. Mësohet se takimi u mbajt në një studio muzikore, që zotëron një nga anëtarët e këtij grupi nismëtar të kësaj force të re, Arben Skënderi, me vendndodhje pranë Liqenit Artificial. Arben Skënderi nuk është një emër i panjohur. Ai është një nga muzikantët më të njohur, ndërkohë në studion e tij kanë regjistruar këngët e tyre edhe shumë emra të njohur që nga Ardit Gjebrea e deri te Kastriot Tusha.



Rama i veshur me "kanabis", Berisha: Shumë premtues...

Ish-kryeministri Sali Berisha, ashtu si kryeministri Edi Rama e ka pranuar hapur tashmë se i pëlqejnë shumë memet, që qarkullojnë në rrjetet sociale. Berisha është tallur keq me kryeministrin me anë të një postimi në "Facebook". Në meme shihet Rama i veshur me kostum me gjethe kanabisi, ndërkohë që Berisha shkruan se "sezoni i ri 2019-2020 është shumë premtues".



Trump me origjinë shqiptare, nip i Jerliut dhe Sevdijes

Donald Trump është me origjinë shqiptare nga Ferizaj i Kosovës". Ky lajm fals i publikuar së fundmi në rrjetet sociale, sipas të cilit Donald J Trump është nipi i Jerli Jerliut nga fshati Talinoc i Ferizajt. Jerliu ishte i martuar me Sevdijen, gjyshen e presidentit amerikan, por pas një hasmerie në fshat, vendosi të largohej drejt SHBA-ve, ku edhe ndryshoi identitet, thotë artikulli. Në të vërtetë, gjyshi i Donald Trump, Friedrich Trump ishte një biznesmen i suksesshëm amerikano-gjerman, i lindur në Kalstadt të Mbretërisë së Bavarisë. Ai u martua me Elisabeth Christ, vajzë nga një familje tepër e pasur po nga i njëjti qytet. Bashkë patën tre fëmijë, ndër ta edhe Frederick Christ Trump, babain e presidentit aktual amerikan Donald J Trump. Nëna e Trump, Mary Anne MacLeod Trump është me origjinë skoceze.

Këshilla

Duke pasur gjithmonë në mendje shprehjen "Kurrë mos vendosni mbi lëkurën tuaj diçka që nuk do e hani", ne po ju japim disa këshilla shumë të vlefshme. Për një lëkurë të butë e të pastër si të një fëmije, për prekje mbresëlënëse dhe të paharrueshme duhet t'i kushtojmë rëndësi të veçantë lëkurës sonë. Duke qenë se lëkura e fytyrës vazhdimisht grumbullon papastërti, edhe pastrimi e kujdesi ndaj saj duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i rregullt. Është e rëndësishme të theksojmë që kujdesi ndaj lëkurës duhet të jetë sa më natyral dhe produktet të jenë delikate, pa përbërës kimikë dhe sintetikë.

RITUALI I ZAKONSHËM

Përveç sapunit që të gjithë e dimë që duhet përdorur 2 herë në ditë (larje me ujë të ftohtë edhe në dimër), lëkura do edhe përkujdesje të tjera. Lëkurat e thata dhe të yndyrshme janë më problematike se lëkura normale, rrjedhimisht duan më shumë kujdes. Hapi i parë (pas sapunit) është skrabi. Në mënyrë që ajo të jetë sa më e gatshme për t'u pastruar nga pikat e zeza dhe njollat, duhet të jetë pastruar më parë nga shtresa e qelizave të vdekura, që e pengojnë lëkurën për proceset e tjera të pastrimit dhe ushqyerjes.

1. Skrabi duhet bërë 2-3 herë në javë për lëkurat e yndyrshme, 2 herë në javë për lëkurat e thata, 1 herë në javë për lëkurat normale (skrabi duhet bërë me shumë delikatesë pa ushtruar forcë, duke ndihmuar me lëvizje rrethore në gjithë fytyrën). Skrabi eliminon toksinat nga lëkura, qelizat e vdekura dhe papastërtitë e sipërfaqshme, të cilat e bëjnë lëkurën të duket pa jetë, e vrazhdë dhe e plakur. Përveç kësaj, qelizat e vdekura bllokojnë porët duke mos e lënë atë të ajroset siç duhet, madje as të lahet siç duhet me sapun. Pra, është një hap i domosdoshëm. Pasi është hequr shtresa me qeliza të vdekura, lëkura është më e gatshme të pastrohet dhe ushqehet në thellësi. Skrabe 100% natyrale me lajthi dhe bajame të grira, për çdo lloj lëkure gjeni në dyqanin me



4 hapa për një lëkurë të pastër si një fëmijë



bimë mjekësore.

2. Avulli, i cili duhet bërë të paktën një herë në muaj, (avulli duhet bërë pas skrabit siç shpjeguar më lart). Ky ndihmon në qarkullimin e gjakut dhe në pastrimin e pikave të zeza. Skrabi dhe avulli ndihmojnë edhe në pakësimin e akneve apo puçrrave. Sh-toni vaj esencial të livandos dhe sherebelës, që avulli të jetë më i efektshëm për pikat e zeza, ose vaj esencial rozmarine, që avulli të jetë më çlodhës për lëkurat e stresuara.

Kujdes, avulli nuk duhet

të zgjasë më shumë se 10 minuta.

3. Maskë pastruese dhe ushqyese pas avullit

Maska jonë multifunktionale "Efira" (e cila ka efekte të shumëfishta pasi është zbardhuese, ushqyese, tonifikuese) është e formuluar për t'ju përshtatur çdo lloj lëkure. Kjo maskë është e përsosur për pastrim të thellë të pikave të zeza, zbeheje të njollave kafe dhe qukave, si edhe në ushqyerjen dhe hidratimin e lëkurës. E pasuruar me mjaltë dhe vajra bimorë, dhuron butësi dhe vitalitet.

4. Pas skrabit, avullit, maskës, rituali përfundohet me masazh fytyre. Për masazh duhet patjetër vaj bajamesh të ëmbla, lajthie ose kokosi të cilat ndihmojnë në mbylljen e poreve dhe në raste më problematike kokosi vazhdon pastrimin e pikave të zeza duke i nxjerrë ato më në sipërfaqe, kështu do ta kenë më të lehtë pastrimin e tyre me një tampon pamuku. Pra, masazhi me vajra ndihmon në pastrim akoma më të thellë, shtrëngim poresh, tonifikim të lëkurës së fytyrës dhe

ushqim të vazhdueshëm të saj.

KËSHILLA TË TJERA TË SPECIALISTËVE JANË KËTO:

1. Në momentin që zgjidhni produktet për fytyrën tuaj të shtrenjtë, lexoni mirë përmbajtjen e tyre në etiketë. Nëse etiketa përmban dhjetëra emra kimikatesh që as nuk i njihni, bëni mirë të mos e blini.

2. Në momentin që vendosni të blini, atëherë duhet që të gjitha produktet të jenë të paktën të një linje. Nuk është mirë që kremi i ditës të jetë linjë tjetër, kremi

i natës nga një linjë tjetër, pastruesi i makiazhit tjetër linjë, e kështu me radhë.

3. Mos bëni skrabe, avull e pastrime më tepër se ç'duhet sepse e dëmtojnë lëkurën.

4. Përmbajtjet agresive shmangini plotësisht.

5. Masazhoni fytyrën çdo natë para se të flini, kjo do të ndihmojë jo vetëm për një gjumë të qetë, por edhe për të mbajtur fytyrën në formë.

6. Mos e prekni lëkurën gjatë ditës me duar të papastura. Duart mbajnë shumë mikroba, të cilat e "sëmurin" lëkurën e fytyrës.

BOTIMI

Nga fëmijëria e tij, te malli për nënën, a një monolog vaji për Naim Frashërin, raporti me Zotin dhe ironia për komunizmin, xhirimi i filmave dhe ndalimi i fesë

DHIMITËR ANAGNOSTI:

Xhirimet e filmit "Gjoleka...", ia dola nga kujdesi i Rozës

Fatmira Nikolli

Fjala ishte e para, fjala do të jetë e fundit. Nuk vdes fjala, vdes njeriu. Fjala është drejtpeshimi universal, fjala është frymë: që qesh, që qan, që ledhaton, që qorton, që urdhëron, që ndërton, që mashtron, që shpif, që vret, që lutet, që... Fjala është arsyeja superiore... fjala... Bëni kujdes me fjalën!... Fjala e ka shtëpinë në mendjen e njeriut, atje ku përleshjen egërsisht, tinëzishit... Zoti me Djallin për të fituar shpirtin e njeriut, që do të thotë, për t'i diktuar atij fjalën!

Një himn për fjalën qëndron në faqet e para të librit më të fundit të Dhimitër Anagnostit "Ulliri, pema e dhimbjes / Tregime, skica, novela" që u promovua dje nga botimet "Tona".

Regjisori vjen para lexuesit me një sërë shënimesh, duke vënë si parathënie kujtime nga koha kur xhironte filmin "Gjoleka, djali i Abazit". Mandej, ai rrefën personazhet që ka takuar kur xhironte filma a kur zgjidhte vendxhirimet, malësorë e djem të rinj, burra nga fshati i lindjes me plot ngjarje për të treguar. Janë më tej historia e një partizaneje, përcjellja e së bijës në aeroport, disa mendime për vitin e mbarshtë 1997, rrefime nga udhëtimet e tij në Shqipëri e jashtë saj. Gjen në libër histori pagëzimi në fund të luftës për të cilat thuhet "U pagëzua si Krishti në stallë dhe "mbajti për tërë jetën kryqin e tij në Golgotën socialiste shqiptar". Më poshtë një fragment nga libri.

PJESË NGA LIBRI

Në vend të parathënies
- monolog -

Fizikisht ndihem mirë. Xhirimet e filmit, "Gjoleka, djali i Abazit" qenë një provë e rëndë, të cilën e përballova aq mirë, sa shumica u besuan. Nuk e di nga më erdhi ajo energji! Besoj se dy kanë qenë arsytet: frymëzimi, dëshira për të bërë edhe një film, pas një heshtjeje tepër të gjatë dhe kujdesi i gjithëloshëm i Rozës...

Jam në prag të të shtatëdhjetave, në janar të vitit 2006 imbutsh. Dikur, diku, kam bërë një shënim të tillë: "Në pleqëri, njeriu i dobësohet shikimi, sepse nis të shohë më tepër brenda vetes, se jashtë saj..." Ndonëse ndihem mjaft mirë fizikisht, nuk ka vend për optimizëm të tepëruar: jetëgjatësia e meshkujve të familjes sime, në dyqind vjetet e fundit nuk e ka kaluar shifrën 70: im



Anagnosti flet për vitet që ka heshur; nga lufta e klasave, te viti 1997

atë, gjyshi, stërgjyshi e stër-stërgjyshi... vdiqën në këtë moshë. A duhet të trishtohem? E kam shkruar edhe diku tjetër, se biologjikisht jam i pavdekshëm, sepse ADN-ja ime udhëton në përjetësi, përmes brezave në vijim.

Përse i shkruaj këto rreshta?! Që të "bisedoj" me fëmijët e mi e me fëmijët e tyre e më tej e më tej në breza për të kuptuar çfarë i jep jetës nxitje, energji, kuptim. Si të jetohej ajo më mirë, në kuptimin material, intelektual, moral dhe emocional. Njeriu nuk është vetmitar, jeton brenda një bashkësie të vogël, që është familja, dhe një bashkësie të madhe, që është shoqëria, në nivel lokal, kontinental apo global, e ndoshta universale.

Ajo që e "mundon" me shumë njeriun është përkohshmëria e tij brenda përjetësisë universale, ndaj njerëzit përpigën të "jetojnë" tej vdekjes fizike, duke vazhduar të "jetojnë" në memorien kolektive të brezave që vijojnë, përmes kontributit të tyre në thesarin kulturor, shkencor, artistik etj., të njerëzimit... Njerëzit e zakonshëm "gënjajnë" veten duke u "përjetësuar" me daljen në fotografi e duke u lënë pasardhësve shembëlltërinë e tyre, kjo kushton fare pak dhe bëhet lehtë.

Të fuqishmit e kësaj bote, ndërtojnë piramida, mauzole, skulptura, piktura etj. Unë mendoj se jetoja një jetë të plotë, në të gjitha parametrat e saj dhe i sigurova ADN-së sime një rrugëtim të sigurt: po kjo nuk mjafton. Po iu lë disa

porosi vajzave të mia, që të bëjnë kujdes në ndërtimin e jetës së tyre: ta ngrenë hera-herës kokën nga problema e përditshme dhe të shikojnë nga "Ylli Polar", për të mos humbur drejtimin e rrugëtimin. Në atë vend, në atë truall ku brezat kanë derdhur energjitë fizike, intelektuale, morale e shpirtërore, atje ku ata kanë vdekur e janë varrosur; rrezatohet një energji misterioze e shumëllojshme, që ta bën jetën më të lehtë, më të plotë, më me kuptim... energjia e memorisë historike.

Njeriu është një qenie shpirtërore, që vjen nga misteri dhe shkon prapë drejt tij. Në këtë rrugëtim misterioz të ADN-së, vdekja i jep energji e frymëzim jetës, asaj jete brenda së cilës udhëton ADN-ja e të vdekurit. Brezat, që në krye të

herës, janë munduar të ndriçojnë "misterin e jetës e të vdekjes...", dhe nëse arrijnë një ditë ta bëjnë këtë, atëherë do të fillojë kaosi, pra, do të kthehemi atje nga jemi nisur: Po kjo s'ka për të ndodhur Flemë e zgjohe-mi, flemë e zgjohe-mi... "Mos kini frikë", ka thënë i mençuri Sokrat, "do të ikim nga kjo jetë, njësoj siç na zë gjumi, me të vetmin ndryshim, që nuk do të zgjohe-mi".

Le të zbresim në tokë: meqë jemi të përkohshëm, për të zgjatur këtë kohë ka dy mënyra: e para, përdorimi racional i kohës, pra koha të jetohej në mënyrë intensive me vepërimtari gjithfarëshe në dobi të familjes e shoqërisë dhe, e dyta, është jetëgjatësia, që, gjithsesi, ka limitin e vet. Kryesorja, që jeta të jetohej në mënyrë intensive, duhet që njeriu të bëjë një punë shoqërisht të dobishme, e cila të jep edhe kënaqësi emocionale dhe të bën të lumtur. Kjo jetë bëhet atje ku është gjithë energjia e fisit tënd dhe veçanërisht e prindërve. Le të jemi bashkë me fëmijët tanë, kur të vijë caku i mbarrmë! Një ditë do të ndodhë, e di si vdekja!

ULLIRI, PEMA E DHIMBJES

Ngado që të arratiset mendimi, në netet pa gjumë a në vetminë e ditëve me shi e me mjegull, apo në gjumin e trazuar me ëndrra e përjetime, që fanepsen aq qartë, si të ishim zgjuar, ai do përplasat në terrin e misterit pa mundur t'i ndriçojmë asnjë tipar.


...Ndez kandilin me vaj ulliri dhe, përmes dritës së tij drithëruese, mundohem të ndriçoj errësirën për të gjetur shtegun që do të më çojë te dera e misterit... E kërkoj e s'e gjej... I dëshpëruar ulem e mbështes kurrizin te trungu i ullirit të madh, atje ku ulej për të pushuar pak mëma ime... Ngre kokën e shikoj kurorën e tij në qiellin e errët... Kandili me vaj ulliri ndriçon trungun e ashpër e degët e përthyer, gjithë gunga e ngërçe, që "rënkojnë" në një vuaajtje e dhembje pa fund... "Lotët" e tij vajorë pikojnë nga çdo kokërr; pikojnë e digjen për të ndriçuar fytyrën e birit të perëndisë e shpirtin e mëmës sime, që gjithë jetën e saj e kaloi gërmuq duke mbledhur kokrrat e bekuara për të bërë vajin e kandilit e për të thënë lutjen e saj të dëshpëruar për ndjesë, mëshirë e ndihmë...

Ja dëgjove lutjen, o Shën Mëri, o mëma e Jezu Krishtit?! Ja dëgjove lutjen, mëmës sime?! Kam një jetë që të pyes dhe ke një jetë që nuk më përgjigjesh...

BIOGRAFI E AUTORIT

Dhimitër Anagnosti lindi në fshatin Vuno, Himarë, më 1936. Kreu shkëlqyeshëm gjimnazin "Ali Demi", Vlorë. Studimet e larta i kreu në Institutin Kinematografik - VGIK, Moskë (1954-1960), ku u diplomua për kino-operator (drejtor fotografie). Xhironi si punë diplomante film-in "Njeriu kurrë nuk vdes" - sipas tregimit të Heminguej, që u vlerësua me "Cmimin e Parë" në Festivalin e Shkollave Kinematografike në Holandë (1961). Pas studimeve u emërua në Kinostudion "Shqipëria e Re", ku dha kontributin e tij të gjatë e të rëndësishëm si regjisor, skenarist e kino-operator në zhvillimin e artit të ri të kinematografisë shqiptare. Filmat e tij janë vlerësuar e vazhdojnë të vlerësohen nga publiku e spektatori shqiptar. Puna e tij si kinestat është vlerësuar me tri Cmime të Republikës së Shqipërisë (1969, 1979, 1983); me tri Kupa të Festivalëve të Filmit Artistik Shqiptar e shumë cmime të tjera. Filmat e tij më të spikatur, si "Lulëkuqet mbi mure", "Në shtëpinë tonë", "Përrallë nga e kaluara", "Gjoleka, djali i Abazit" etj. janë vlerësuar me cmime ndërkombëtare në vitet (1980, 1983, 1985, 2005, 2006). Në një ceremoni madhështore në Romë, iu akordua cmimi i rëndësishëm "Il Lazio tra Europa e Mediterraneo", 2006 - për audiovizivin dhe kontributin në zhvillimin e artit në Shqipëri, ku u vlerësuan dhe u ndëruan tetë personalitete nga vendet e Mesdheut. Në vitin 1987 u nderua me titullin e lartë "Artist i Popullit", ndërsa në vitin 1995 me "Cmimin e Karrierës" në Festivalin e 10 të Filmit Artistik Shqiptar. Ka qenë deputet i Partisë Demokratike në parlamentin e parë pluralist shqiptar dhe në vitin 1992 u emërua ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në qeverinë e parë demokratike. Më pas krijoi dhe drejtoi Fondacionin "Fan S.Noli" për kulturën dhe artin. Në vitin 1995 shkroi dhe vuri në skenë dramën "Nata e trokitjeve në xhama" dhe në vitin 2006 u shfaq filmi i tij më

i fundit "Gjoleka, djali i Abazit". Ka dhënë vazhdimisht kontributin e tij në përgatitjen profesionale të brezit të ri të kinestavëve. Gjatë viteve të fundit, aktiviteti i tij artistik ka vazhduar me publikimin e veprave të tij letrare. Për kontributin e tij në kulturën dhe artin shqiptar është vlerësuar me titullin e lartë "Nderi i Kombit" nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë (2011).



DITA NDËRKOMBËTARE E LIBRIT

Biblioteka Kombëtare pasurohet me një përkthim të Virgjilit

Fatmira Nikolli

Dorëshkrimi i përkthimit nga latinishtja të veprës "Gjeorgjikat" nga Mark Dema

Fondi i vlerave të rralla të Bibliotekës Kombëtare u pasuroi me dorëshkrimin e përkthimit nga latinishtja të veprës madhore "Gjeorgjikat" të Virgjilit, sjellë në gjuhën shqipe nga mjeshtri Mark Dema. Dorëshkrimi iu dhurua prej birrit të tij, Alfred Dema, në kuadër të Ditës Botërore të Librit. Fondi i dorëshkrimeve në BKSH numëron rreth 1189 vepra të dorëshkruara, kryesisht në gjuhët orientale (arabisht, osmanisht dhe persisht), shumica e të cilave janë kopjuar nga kaligrafë të specializuar në Shkodër, Berat, Elbasan, Tiranë etj. Shumica e dorëshkrimeve orientale u takon shekujve XIII-XIX. Ato shquhen për miniaturat në ar dhe dekoracionet. Pjesë e koleksionit janë edhe disa dorëshkrime në gjuhë perëndimore, ndër të cilat me vlerë të veçantë për Shqipërinë është ditari i albanologut hungarez Franc Nopça "Albania Notizbücher" në 6 vëllime, shkruar gjatë viteve 1905-1909, 1913 etj. Nga dorëshkrimet greqisht, i rrallë dhe i rëndësishëm është kodiku për Shën Nikodhimin nga Berati, i dorëshkruar në fillim të shek. XVIII. Disa nga këto vlera të çmuara të fondit të BKSH-së u ekspozuan për publikun.

"FESTA E LIBRIT"


Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë çeli të martën, më datë 23 prill, javën e veprimtarive kulturore që do të zhvillohen në kuadër të Ditës Botërore të Librit dhe të Drejtës së Autorit, përmes takimit të ministres së Kulturës, Elva Margariti, me specialistët e Bibliotekës Kombëtare. Drejtoresha Persida Asllani shprehu nevojën për një bashkëpunim sa më të koordinuar ndër-institucional në mbështetje të Bibliotekës Kombëtare, por edhe të rrjetit të bibliotekave në vend, si hapësirat me cilësore të dijes, të informimit, të leximit të letërsisë dhe zhvillimit shpirtëror, mendor e estetik të qytetarëve. Gjatë bashkësisë së specialistëve e bibliotekës, ministria e Kulturës, znj. Elva Margariti, theksoi vëmendjen e veçantë jo vetëm institucionale, por edhe personale "për një zgjidhje afatgjatë e cilësore të situatës në të cilën gjendet Biblioteka Kombëtare aktualisht" si dhe premtoi "krijimin e Agjencisë Kombëtare të ISSN-së pranë Bibliotekës Kombëtare". Krijimi i Agjencisë Kombëtare të ISSN-së, e cila do të pajisë me numrin ISSN, të gjitha botimet periodike si: gazeta, revista, - përfshirë edhe ato shkencore, - në format të shtypur ose në formë elektronike, si një domosdoshmëri në fushën e botimeve do të ndihmonte jo vetëm bibliotekat në kryerjen e përkthimit bibliografik të periodikut sipas stan-



darëve ndërkombëtare dhe shkëmbimin e të dhënave në rrjetet globale të informacionit, por edhe botuesit për tregtimin më të mirë të botimeve të tyre brenda apo jashtë vendit si dhe botën akademike - shkencore në përpjekjet integruuese euro-atlantike të botimeve të tyre kërkimore e shkencore. Në kuadër të veprimtarive që u zhvilluan në kryeqytet në Ditën Botërore të Librit dhe të Drejtës së Autorit, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë iu bashkua edhe aktiviteteve të shumta kulturore të organizuara nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universite-

AKTIVITETI

Në ditën Ndërkombëtare të Librit, në Qendrën për Hapje e Dialog në Kryeministri, me qëllim afrimin e të rinjve me librin kanë lexuar edhe personazhe të njohura publike si Edi Rama, Lorik Cana, Erna Andrea, Niko Peleshi, Mirela Kumbaro etj.



ti i Tiranës, ku u promovuan disa nga botimet më të fundit studimore e letrare, u zhvilluan tryeza të rrumbullakëta, Festivali i Krijimit Letrar, interpretime të krijimtarive artistike nga Klubi i Dramës të studentëve të Departamentit të Letërsisë si dhe Panairi i Librit. Biblioteka Kombëtare promovoi botimin më të fundit "Lumo Skëndo dhe themelimi i revistës "Diturija" - Aktet e Konferencës Shkencore, zhvilluar në Tiranë e Prishtinë 2018, në kretimet e 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit & Bibliografi e revistës "Diturija".

LIBRI I LULJETA LLESHANAKUT, FINALIST NË KANADA



Pas vlerësimit me çmimin PEN-i anglez dhe përzgjedhjes si finalist për çmimin "PEN America 2019", përmbledhja me poezi "Negative space" e Luljeta Lleshanakut, e përkthyer mjeshhtërisht nga Ani Gjika dhe e botuar njëkohësisht në Mbretërinë e Bashkuar nga "Boodaxe Books" dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga "New Directions" gjatë vitit që shkoi, përzgjedhet si një nga katër librat finalistë për çmimin ndërkombëtar "Griffin", në Kanada. Çmimi "Griffin" është themeluar në vitin 2000 nga biznesmeni dhe filantropisti Scott Griffin dhe jepet çdo vit në dy kategori: për poezinë ndërkombëtare të shkruar apo të përkthyer në anglisht dhe për poezinë kanadeze. Fitues të mëparshëm të këtij çmimi kanë qenë autorë të njohur si: Anne Carson, John Ashberry, Charles Simic, Charles Wright, Paul Muldon, Heather McHugh, Paul Celan etj. Në argumentin e saj për përzgjedhjen e librit

"Negative space" si finalist, juria e çmimit "Griffin" shprehet: "Sa më pak e njohur gjuha origjinale, aq më e vyer bëhet dhurata e përkthimit! Libri 'Negative Space' i Luljeta Lleshanakut sjell një vështrim të rrallë tek poezia shqiptare bashkëkohore. Rrjedhshëm e me saktësi të mprehtë, Ani Gjika e cila është edhe vetë poete, ka mundur të shprehë në anglisht jo vetëm poezitë e 'Negative Space', por edhe atmosferën e ngrysur që zotëron gjatë gjithë librit, një ndjesi e thellë përkohshmërie, që është pasojë e së

jetuarit nën presionin e ashpër politik. 'Negative Space' është gjithkund pjellore. Duke hapur portën e traumës, në ballafaqohemi me një zë të butë dhe inteligjent, me ngjarje që nxjerrin në dritë realitetin e një njerëzimi të përbashkët, duke i rikthyer dinjitetin këtij njerëzimi. Në një botë të përçarë nga terrori e dhuna, poezia e Lleshanakut është përherë trazuese, por edhe qetësuese për ne, banorët e saj". Ndërkohë, në një recension të titulluar "Mbi Luljeta Lleshanakut", të botuar në të mirënjohurën "Lon-

don Review of Books" në fillim të muajit prill, shkrimtari dhe kritik i Michael Hoffman ndër të tjera shkruan: "Këto janë poezi të esencës dhe imagjinatës, në dukje të pavetëdijshme për lexuesin dhe kritikun dhe sigurisht që nuk luanë me ta, të qarta dhe në pjesën më të madhe të natyrshme, ato e vendosin Lleshanakun afër poetëve të mëdhenj të Evropës Qendrore dhe Lindore të shekullit të 20: Akhmatova, Herbert, Holub, Szymborska, Zagajewski". Çmimi "Griffin" konsiderohet si një nga më të rëndësishmit dhe më bujarët, pasi kap shumën 65 mijë dollarë kanadezë, që ndahet midis përkthyesit dhe autorit, ndërkohë që secili nga finalistët shpërblehet me 10 mijë dollarë kanadezë. Libri "Negative Space" është përmbledhje e dy librave me poezi "Pothuajse djë" dhe "Homo Ant-arcticus", të botuara në origjinal nga shtëpia botuese "OMBRA GVG". Përkthyesja Ani Gjika është vlerësuar edhe me grant nga "National Endowment for Arts" në SHBA për këtë përkthim.

Opinion i Ditës

Rama ka të drejtë, zgjedhjet nuk duhet të shtyhen

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... ka qenë i prerë, shtyrje nuk do të ketë. Ndërsa Bernd Broshard ka pyetur me ironi reporterët që i kanë zgjatur mikrofonin: "E ç'të mirë do të sillte shtyrja?"

Në fakt, edhe pohimi i Ramës edhe ai i diplomatit, jetëgjatësia e të cilit varet nga projektet që i miraton qeveria, kanë diçka racionale. Sepse 30 qershori, si një datë tashmë e dekretuar nga presidenti, do të kishte kuptim të ndryshohej vetëm me kushtin e pjesëmarrjes së opozitës në garën lokale.

Po a ka sot opozita mundësi të përfshihet në këtë garë, pasi ka djegur mandatet me arsyetimin se nuk zhvillohen dot zgjedhje të ndershme, të lira dhe të barabarta me këtë kryeministër?

Një veprim i tillë do të ishte një kamikazeri politike e paimaginueshme.

Sepse zgjedhjet në këtë vend



nuk mund t'i shpëtojë, as ndonjë lëmoshë e minutave të fundit, as ndonjë garanci ndërkombëtare, apo premtimi se

Gjushi në Durrës apo Lala në Elbasan u hoqën qafe, e aq më pak ndonjë kompromis për "lëshimin" e ndonjë qyteti të

madh.

Nëse me largimin përfundimtar nga parlamenti, opozita pati si qëllim ta nxjerrë lakuriq

regjimin e Ramës, nëse ajo u vetësakrifikua për të shërbyer si pasqyrë, ku njerëzit të shohin se të gjitha pushtetet i ka në dorë një njeri i vetëm, ajo duhet t'i shkojë në ekstrem kësaj rruge: pra t'i braktisë edhe zgjedhjet lokale. Ta lërë të shpërfaqet deri në fund parodia e një pushteti që do të garojë me vetveten, që do të bëjë sikur ndeshet me palaçot që ka krijuar vetë, e që do të kthejë në lolo vëzhguesit ndërkombëtarë që do të sillen sikur monitorojnë një garë të rregullt.

Pra, në këtë kuptim, ajo që opozitës i duhet më pak, është një shtyrje e datës së zgjedhjeve. Prandaj edhe Rama ka të drejtë kur deklaron me vendosmëri se 30 qershori nuk preket. Ai nuk mund të falë një gjë që, as nuk ia ka kërkuar kush, as nuk i duhet kujt.

Por edhe mbështetësi i tij, Broshard, nuk e ka gabim kur ngre dilemën se ç'do përfitohej nga zhvendosja e 30 qershorit. Këtu të gjitha palët bien dakord: E pse u dashkan bërë zgjedhjet detyrimisht me opozitën?

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

GAZETA SHQIPTARE

Opinioni *i* Ditës

Shërbëtori i popullit

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faja 1)

... popullit", fitoi zgjedhjet presidenciale të zhvilluara dy ditë më parë në Ukrainë. Ishte një fitore e papritur dhe spektakolare. Komediani 41-vjeçar rrëmbeu mbi 73 për qind të votave të mbi 28 milionë ukrainasve që votuan. Pse? Sepse e përqendroi fushatën e tij zgjedhore mbi luftën pa kompromis ndaj korrupsionit. Në një kohë kur ukrainasve të thjeshtë iu kishte ardhur në majë të hundës me skandalin e qeverisjes. Me një sistem politik që vetëm i zhgënjente dhe prodhonte tendera e kontrata të marra gati tërësisht nga kompanitë pranë presidentit të vendit. Rivali i komedianit, presidenti në detyrë Petro Poroshenko, oligark në industrinë e çokollatave me markën "Roshen", mori vetëm 25 për qind të votave. Në një kohë kur pesë vite më parë ishte idhulli i ukrainasve në revolucionin e Dinytjetit (Euromaidan), në qëndresën e tyre ndaj dhunës dhe krimeve të shtetit policor të Janukoviçit. Po pse? Sepse në pesë vitet e presidencës së tij (2014-2019) nuk mundi të shkëpusë fijet e qeverisjes me oligarkët e shumtë që i rrethuan qeverinë. Lejoi si praninë e tyre, ashtu edhe lojën e influencave që ia robëruan të gjithë ministrat. Ky shtetdrethim, ky sulm i pashoq i drejtuesve të kompanive më të mëdha të ndërtimit dhe të shërbimeve të vendit në gjuajtje të parasë publike solli humbjen e mbështetjes në popull të Poroshenkos, njeriut që e afrooi Ukrainën si kurër më parë me Bashkimin Evropian dhe me NATO-n. Ukrainasit e thjeshtë e humbën besimin të qeverisja e tij, edhe pse nën Poroshenkon u liberalizuan vizat me vendet e Shengen-it në BE. Sot askush në Ukrainë nuk njih mirë bindjet politike dhe programin ekonomik të Zelenskijit. Nuk është në gjendje të thotë se si do të sillte presidenti i porsazgjedhur. Aktori e bazoi fushatën e tij me mesazhe në rrjetin e medias sociale "Twitter". Eksperienca e tij politike nuk është më e vjetër se këto tre muaj fushatë. Ngjithja e tij në politikë i ngjan deri diku katapultimit në politikë të aktorit komik italian Bepe Grilo, themelues i lëvizjes "Pesë Yjet", një nga forcat politike bazë të qeverisjes në Italinë e sotme. Edhe Grilo ironizonte me sarkazmën e tij korrupsionin e thellë të sistemit politik italian. Italia vinte nga zhgënjimet e qeverisjes së oligarkut të sektorit të ndërtimeve dhe të mediave, Silvio Berlusconi dhe lëvizja e Grilos fitoi. Po ashtu edhe në Ukrainë, njerëzit e votuan komedianin Zelenskij vetëm pse pamë tek ai një njeri të ndershëm dhe me integritet, krahas së qenit një aktor i shkëlqyer. Kjo votë masive tregon dëshpërimin e popullit ukrainas dhe refuzimin e tij për të votuar sistemin politik të servitur nga politikanët e derisotëm. Demokracia e brishtë e këtij vendi, me një



ekonomi të ndërvarur me probleme të mëdha të kujton jo pak gjendjen tonë, si ekonomike ashtu edhe të korrupsionit që ka kllapuar të gjithë administratën tonë shtetërore. Dhe ne, njësoj si Ukraina, i kemi tenderat tanë publikë të kapur me mijëra fije me oli-

garkët tanë. Ku çdo sipërmarrës i vogël, i ndershëm e ka të vështirë, gati të pamundur të fitojë para publike në një garë të drejtë. Ku gara është e trukuruar që në fillim. Ku që në fillim dihet se kush do ta fitojë x apo y tender. Do të jetë e vështirë të dalim nga

kjo kllapi oligarkie që ka 10 vjet që çelënikoset me favore të dyanshme, si nga oligarkët, ashtu edhe nga politikanët që i ndihmojnë të fitojnë tenderat, paranë e shqiptarëve. Kryeministri i sotëm, pasi e lejoi shtetin e kapur për rreth gjashtë vjet, u shkëput nga një oligark ndërtimi rrugësh, pas një skandali të shpërthyer pesë muaj më parë me një kompani fantazmë nga SHBA-të, që fitoi dy tendera me vlerë 30 milionë euro për llogari të oligarkut. Ende nuk e dimë nëse është shkëputje e detyruar, apo hapje sysh më në fund. Qeveria ktheu mbrapsht një tender dhe kontratë të fituar prej 475 milionë eurosh të këtij oligarku, për një aks rrugor. Por, kjo nuk mjafton. Duhet që qeverisja jonë të shkëputet nga të gjithë oligarkët-hidra që i pluskojnë përreth. Do të jetë mision shumë i vështirë. Por, shtegu i nisur duhet vazhduar. Pse është rrugëdalja e vetme për të rikthyer besimin e humbur të qytetarëve tanë. Për të dalë në pozicionin e shërbëtorit të popullit, të shërbëtarit, të burrit të shtetit jo thjeshtë dhe vetëm me propagandë, por edhe me veprime konkrete në vijueshmëri.

Komediani 41-vjeçar rrëmbeu mbi 73 për qind të votave të mbi 28 milionë ukrainasve që votuan. Pse? Sepse e përqendroi fushatën e tij zgjedhore mbi luftën pa kompromis ndaj korrupsionit. Në një kohë kur ukrainasve të thjeshtë iu kishte ardhur në majë të hundës me skandalin e qeverisjes. Me një sistem politik që vetëm i zhgënjente dhe prodhonte tendera e kontrata të marra gati tërësisht nga kompanitë pranë presidentit të vendit. Rivali i komedianit, presidenti në detyrë Petro Poroshenko, oligark në industrinë e çokollatave me markën "Roshen", mori vetëm 25 për qind të votave.

HOROSKOPI

DASHI

Në sjelljen tuaj do të vihen re shenja arrogante. Edhe nëse keni arsye për t'u ndjerë krenarë, mos e shprehni dhe mos e tregoni. Ka gjasa që të rritet numri i personave që ju kanë zili dhe kjo do t'ju përballë me disa vështirësi.

DEMI

Demat duhet të përqihen të mos konfliktohen me askënd. Mëshohuni të eliminooni paqesisht situata të tilla. Ky do të jetë edhe çelësi i ekuilibrit tuaj emocional. Është dita e duhur për të bërë disa riparime në shtëpi. Shmangni udhëtimet e gjata dhe mjekimet e tepërta.

BINJAKET

Binjakët do të kenë vështirësi në komunikim. Ka gjasa që iniciativa personale, rretime, ndjenja apo zhvillime kreative të rmbeten të padëgjues. Rekomandohet që ta shpenzoni kështu ditë pa ndonjë aktivitet të veçantë.

GAFORJA

Garforret duhet t'i kushtojnë shumë rëndësi shëndetit. Duhet të bëni patjetër një kontroll mjekësor, ose të konsultoheni me një mjek për mënyrën sesi ndiheni. Duhet të kaloni më shumë kohë nën shoqërinë e familjarëve tuaj.

LUANI

Disa Luanë ka gjasa të nxitonjë për çështje të caktuara. Kjo mund t'ju dëmtojë në çështjet që kërkojnë përgjegjësi. Merrni në konsideratë këtë parashikim dhe mos u nixtoni. Sot keni shansin të riktheni krenarinë dhe suksesin.

VIRGJERESHA

Të lindurit e kësaj shenje nuk do të përballen me shqetësime sot. Mos u bëni shumë kritikues ndaj vetes. Kush-tojni më shumë rëndësi pamjes së jashtme pasi kështu do të ndiheni edhe më mirë. Në mbërmeje do të ndiheni të përkëdhelur nga partneri/partnerja juaj.

PESHORJA

Rrezikoni të humbini një shans mjaft të mirë. Modestia nuk do t'ju lejojë t'i shprehni ndjenjat dikujt. Joga, meditari apo sporti do të ndikojnë mjaft mirë të ju. Nuk rekomandohen udhëtimet e gjata. Ka gjasa të bëni disa blerje të panevojshme.

AKREPI

Disa Akrepë do të jenë shumë të kujdesshëm. Natyra dyshuese do t'ju ndihmojë të shmangni disa probleme dhe takime aventuriere. Tregohuni të singërtë ndaj vetes dhe bashkëbiseduesve. Ka gjasa të konfliktoheni me një fqinj ose një koleg.

SHIGJETARI

Shigjetarët nuk do të kenë probleme gjatë kësaj dite. Nëse dëshironi, mund të përqendroheni në gjëra që mund t'ju çojnë në majë të karrierës. Sipërmarrësit duhet të mendojnë për të gjetur ide të pazakonta.

BRICJAPI

Sot do të keni mundësi të shfaqni një prej talentëve tuaja. Madje, mund të ngjalli edhe interesin e publikut. Bëni kujdes gjatë komunikimit dhe tregoni më shumë takt. Nuk do të keni të papritura gjatë ditës së sotme dhe pjesa më e madhe e kësaj të mërkure premon të jetë e qetë.

UJORI

Rekomandohet të mos jeni natyrë e mbyllur. Problemet që keni mund t'i diskutoni me familjarët, pasi kështu do të ndiheni më të qetë dhe mund t'i zgjidhni ato. Në të kundërt mund të kontaktoni një psikolog, ose të lexoni një literaturë të veçantë.

PESHQIT

Peshqit do të ndiheni mjaft të lodhur për t'u marrë me çështje urgjente. Ka shumë gjasa që në çdo aspekt të jetës të gjeni çështje që kanë nevojë për zgjidhje të shpejta. Mos u përballni vetë me këto probleme, por kërkoni edhe ndihmën e të tjerëve.

ZHBËHET HISTORIA



Pas logos tradicionale, tashmë e ka radhën fanella. Juventus i epokës moderne kërkon të shndërron gjithnjë e më shumë në një brand të fuqishëm në treg dhe drejtuesit mendojnë ndryshimet e nevojshme për të fuqizuar aksionet në bursë. Prej muajsh ishin në qarkullim zërat që saktësonin se fanella e re e Juventusit nuk do të ishte më me vijat bardhezi, por gjysmë e zezë dhe gjysmë e bardhë, ndërsa

Lamtumirë vija bardhezi, Juventus ndryshon fanellën dhe tërbon tifozët

konfirmimi vjen nga "Footy Headlines", pararojë e dizajneve të fanellave të reja dhe që rralleherë gabon në atë që servir për publikun. Sipas sajtit, fanella bardhezi do të jetë pa vija, ndërsa e bardha dhe e zeza do të ndahen nga një vijë e hollë rozë. Shpina do të jetë e zezë në pjesën dërrmuese të saj. Fanella e

dytë do të jetë e kaltër me vje të verdhë dhe e treta e kuqe. Por, këto ndryshime nuk janë pritur aspak mirë nga publiku bardhezi, me tifozët e Juventusit që kanë shpërthyer ndaj drejtuesve të tyre, duke i akuzuar se po e largojnë gjithmonë e më shumë klubin torinez nga historia e tij.

Një italian do të përfaqësojë Shqipërinë në Xhudo

Duket e habitshme, por është e vërtetë. Marco Madaloni do të garojë për flamurin e Shqipërisë në Botërorin e Xhudos, që do të zhvillohet në Tokio. Lajmin e ka dhënë vetë Madaloni, që pak ditë më parë u shpall dhe fitues i "Isola dei famosi", varianti italian i "Survivors" i drejtuar nga Alesia Markuci. "Do të filloj të stërvitem, sepse në shtator është Kampionati Botëror në Tokio, ku unë do të vesh fanellën e Shqipërisë. Tri vite më parë mu desh të tërhiqesha pasi kisha disa keqkuptime me presidentin e federatës italiane. Më pas takova presidentin e Federatës Shqiptare të Xhudos, i cili më dha shtetësinë për merita sportive, ndaj do të përfaqësoj këtë shtet. Më duhet të rifilloj dinjitetin dhe të tregoj se do të tërhiqem nga ky sport kur e vendos unë", tha Xhuidisti 34-vjeçar italian, që në karrierë ka fituar dy herë medaljen e bronzit në botëror.

Kryeqytetasit udhëtojnë në Gjirokastrë, ndërsa trajneri sheshon debatin me "ish"-ët bardheblu



Jeton Selimi

Mema: Tirana nuk do të ketë fatin e dy sezoneve më parë Kupa, kërkohet rezultat pozitiv ndaj Luftëtarit

Tirana shkon në Gjirokastrë, por mendjen e ka pas. Vërtet gjysmëfinalja e Kupës së Shqipërisë kundër Luftëtarit është e rëndësishme, por në ambientin bardheblu fokusi më i madh është në kampionat, pasi rreziku i rënies nga kategoria është ende i lartë. Por, trajneri Mema nuk heq dorë as nga Kupa e natyrisht, as nga kampionati. "Më pëlqen shumë mënyra si luan Luftëtarit, kam parë videot e tyre këto ditë e fundit dhe është kundërshtar shumë i fortë. Natyrisht, kemi marrë masat tona, tani duhet të mendojmë për dy ndeshje, jo për një. Kërkojmë rezultate pozitive që në vajtjen e Kupës, por realisht Luftëtarit është kundërshtar i fortë, të vë në veshitësi. Po i mendojmë për të dyja ndeshjet, kanë shumë vlerë. E para është për të tentuar afrimin me finalen, e dyta për mbijetesën. Ahmatajn e kam mik, po bën një punë shumë të mirë në Gjirokastrë, është pjesë e brezit të ri të trajnerëve dhe e vlerësoj shumë për atë që ka bërë. Nesër përballim, do t'i tregojë fusha të gjitha. A i përballojmë dot të dyja kompeticionet? Nuk kemi pa-



sur diferenca në lojë me kundërshtarët, nuk kemi marrë pikë për probleme që i kemi evidentuar më herët. Është bërë punë, ekipi ka luajtur mirë, por ndonjëherë episodet dhe fati kanë qënë kundër nesh".

FRIKA E PËRSËRITJES SË DY SEZONEVE MË PARË
"Nuk mendoj se është e njëjta situatë me 2 vite më parë. Tirana nuk është se ka bërë atë që ka bërë vitet e shkuara, si për shembull të mos fitojë për 13 ndeshje rresht. Ne kemi fituar, ashtu siç kemi lënë pikë si në ndeshjen me Laçin për shembull, apo në Vlorë, ku humbëm penallti. Me ato 3 pikë do ishin ndryshe renditja, por rëndësi ka që në vazhdim të mos bëjmë gabime të tilla".

PRESIONI KLASIFIKIMIT
"Po, na e ka shtuar shumë presionin, por kundër Kukësit nuk e patëm përgendrmin e duhur, edhe pse ekipi nuk luajti keq, pavarësisht se renditja krijon presion. Ndoshta kam gabuar edhe unë, filozofia ime është që një ekip që sulmon e tremb kundërshtarit, por natyrisht duhet shumë kujdes edhe në aspektin mbrojtës".
GOLAT E PËSUAR ME THJESHTËSI
"Ajo është pjesa që më ka ngacmuar dhe më mërziit ende, kemi dhuruar dy gola dhe duhet të tregohemi më të përgjegjshëm. Nuk mund të falim gola të tillë gjithë sezonin. Një futbollisti i kam thënë që një gabim në 30 ndeshje lejohet, por ne na ka ndodhur shpesh. Ndoshta jam unë fajtori, secili duhet të

marrë përgjegjësitë e veta dhe në 99% të rasteve, unë marr përgjegjësinë për gabimet që bëjmë".
Sulejman Mema deklaroi se Tirana ka lojtarë mediokër "Nuk kam ndonjë koment, futbollit është paksa subjektiv dhe secili ka mendimin e tij. Varet për cilin e ka dhe në ç'kushte e ka thënë, por secili ka të drejtë të thotë atë që mendo, sipas këndvështrimit të vet, unë mund të kem këndvështrim ndryshe. Irespektoj të gjitha llojet e komenteve, nuk mund të merrem me këto gjëra, sepse rëndësi ka realiteti".
KRITIKANT NGA LEGJENDAT E KLUBIT
"E vërtetë, nuk është momenti për të replikuar me njëri-tjetrin, përtej problemeve personale. Tirana, familja jonë është mbi gjithçka".

MESFUSHORI BELG

Guardiola me dhimbje koke, De Brujn humbet derbin

Guardiola humbet një nga pjesët më të rëndësishme të skuadrës së tij në prag të derbit që mund të vlejë titullin kampion. Siti ndeshjet me Junajtidin ditën e sotme, ndërsa trajneri spanjoll ka nisur të bëjë llogaritë pa ndërkombëtarin belg, që u dëmtua në sfidën e fundit në kampionat kundër Totenhemit. "Është një dëmtim muskular. E kemi ndjekur ditë pas dite, por De Brujn nuk është gati për nesër (sot). Ai ka pasur dy apo tri dëmtime muskulore si pasojë e problemit në gju. Të shpresojmë që ai të luajë një apo dy ndeshje deri në fund të sezonit", u shpreh Guardiola në konferencë për shtyp.



REAL MADRID

Perez bën gati 500 milionë euro për merkaton

Real Madrid po bëhet gati për një merkato prej 500 milionë eurosh. Lajmin e publikon gazeta italiane "Corriere Della Sera" në numrin e sotëm dhe bazohet në çmenduritë që ka ndërmend të bëjë Florentino Perez për ta ringritur skuadrën madrilene në çatinë e Europës. Eden Hazard dhe Pol Pogba janë objektivet e parë të një klubi që me rikthimin e Zinedin Zidane në stol, kërkon të rikthehet të shkëlqejë dhe të hapë një tjetër cikël fitues, që në sezonet e shkuara i solli klubit spanjoll 3 Champions radhazi. "Në shënjestrën e Real Madridit ka edhe emra të tjerë të rëndësishëm, sikundër Gundogan, Jovic dhe Eriksen, por gjithashtu priten shitje po aq të bujshme, sikundër Isko, Kroos, Varane dhe Modriç, që janë gati të ikin nëse vjen një ofertë e rëndësishme", raporton gazeta italiane.


Familja Icardi do të qëndrojë në Milano

Uanda Nara përgënjeshtrohet zërat: Mauro nuk lëviz nga Interi

Uanda Nara, gruaja dhe agjentja e Mauro Icardit, konfirmon fjalët e saj thënë për situatën e fundit të sulmuesit zikaltër dhe qëndrimin e tij me fanellën e Interit. Nëpërmjet mikrofonit të "Striscia la Notizia", në puntatën që do të transmetohet sot në mbrëmje, ajo ndër të tjera ka saktësuar: "Familja jonë është interesante. Jemi në Milano dhe këtu do të qëndrojmë. Jam e sigurt me 100%. Kemi rinovuar qëndrimin në shkollë të fëmijëve, ndaj as nuk e mendojmë largimin. Nëse do t'ia kthejnë shiritin e kapitenit Mauro? Ta shohim si do të shkojë, por për ne nuk është aspak problem".



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Salacrou dramaturg
6. Blair e Ekzorcistit.
9. I bylbyllt ai i Mjedës.
10. Inicialet e Morricones
12. Gjysmë vektor.
13. Një port përballë Xhibutit.
14. Në mes të Salt dhe City.
16. Janë stacionet e beduinëve.
19. Një pjesë e taktikës.
20. Janë tifozë partie.
22. Janë firmat mashtruese.
23. Përpunojnë naftë.
27. Janë konservatorë.
28. Eshhtë derri.
30. Një monedhë maqedonase.
31. Kufizojnë ambiente.
33. Inicialet e Gould aktor.

34. Fillojnë jetën.
36. Janë dëshmorët.
39. U shkrua nga Garcia Lorca.
44. Janë baballarët.
45. Tregon çmimin dhe modelin.
47. Eshhtë ujëvara.
48. Një mund të jetë mbi xhiro.

VERTIKAL

1. Film i James Cameron.
2. Jeronim de i Milosaos.
3. Eshhtë doktori me bluzë të bardhë.
4. Agjenci Informacioni Ndërkombëtare.
5. Janë si jerm.
6. Fillojnë lejen.
7. Klikohet me mouse
8. Një vegël.
11. Luftohet me kinina.
12. Janë cilësi.
15. Janë reaksionet në epruveta
17. Një sportist që kërcen me shkop.
18. Janë tek në zhele
20. Eshhtë kullë xhamie.
21. Bëhet një për zakon.
22. Gruaja e Fantozzi-t
24. Gjysmë afërsi.
25. Janë ndriçues.
26. Nuk duhet shkelur një i tillë.
29. U shkel për herë të oarë nga Neil Armstrong.
30. Një fjalë për goja.
32. Garbo e kinemasë.
35. Braktisi Didonën.
36. Me të bëjnë një thikë.
37. Mund të jetë gjaku.
38. Janë dhoma.
40. Ai dhe ajo.
41. Ushtria republikane irlandeze.
42. Agjenci Transporti Korçë.
43. Me stpon në box.
46. Inicialet e Moravia-s.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

1. Ishite babai i parë.
6. I ndërmarrti progresistët.
14. Thyhet një me kohën më të mirë.
16. U braktis nga Helena.
17. Seritë pa zë.
18. Kryeqyteti i Kinës.
20. Ramazzotti këngëtar.
21. Eshhtë sport me vozitje.
25. Ndërmarre Industriale Rajonale.
26. Janë sherre në shtyp.
27. Inicialet e Clapton.
28. Eshhtë shuma e brinjëve të drejtëndëshit.
30. Një letrar është tregimi.
32. Fillojnë nazet.
33. Matet pa kufij.
36. Inicialet e Kokoschka piktor
37. Kufiojnë mendimet.


VERTIKAL

38. Bergman që qe aktoe.
40. Eshhtë shpërblimi në para.
44. Eshhtë i keq.
45. Mund të kthehet në mlllef.
46. Një pije piratësh.
48. Janë në fazë.
49. Fillojnë lejen.
50. U shkrua nga Theodore Dreiser.
53. Një... italiane.
54. Një verë në Paris.
55. Janë vende ku prehehen martirë.
56. Italia në Internet
1. Wenger trainer.
2. Stefan i interpretuar nga Horst Tappert
3. Një është edhe Bujar Lako
4. Fillojnë mobilizimin.




5. Institucione Rajonale Polake.
7. Një rapper i famshëm.
8. Kështu thirrej Ronaldo, bomberi brazilian
9. Ndezur në aparaturë.
10. Një film i ribërë.
11. Ekstrema në model.
12. Dy asa.
13. Eshhtë fytyra kamionit.
15. Mund të bëhet me medalje trimërie.
19. Mund të jenë të rastit.
22. E ka simbolin Ti.
23. Eshhtë dëm, qeder.
24. Inicialet e Tappert.
26. Një pjesë e pejsazhit.
28. Ndahet në barazim.
29. Janë kandilë deti
31. Hayëorth që qe aktoe
34. Eshhtë enë për të skuqur.
35. Emri i Zola.
39. Gjysma e globit.
41. Janë në skaje.
42. Kryqyteti i Letonisë.
43. Eva... Isabel Allende-s
47. Një stacion i famshëm orbital
51. Inicialet e Lennon.
52. Diftong në duet.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		7		9				3
				1		4		
		9						5
6							8	
	2		9	4			5	
			3		5	9		
8			9					6
5	3		1		8			
		1						

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	7	6	3	2	8	5	4	1
3	8	2	5	1	4	6	9	7
4	5	1	9	6	7	2	3	8
5	9	3	1	8	6	7	2	4
6	1	4	2	7	9	8	5	3
7	2	8	4	3	5	9	1	6
2	6	9	7	4	3	1	8	5
8	4	5	6	9	1	3	7	2
1	3	7	8	5	2	4	6	9

Argëtim filozofik

- Prindërit mund të japin këshilla të mira dhe të tregojnë rrugën e drejtë, por në finale formimi i karakterit të një personi qëndron në duart e veta - Banker: Ai që ju jep ombrellën e tij kur koha është me diell, dhe ua merr atë mbrapa, kur fillon të bjerë shi.

- Një i mençur në mesin e të paditurve, është si një vajzë e bukur në mes të të verbërve.




Thënie të mençura

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



- Në thelb, kur provojmë vetëm një gotë pije për tu dhun. Problemi është se unë nuk e mbaj mend, nëse kjo është e trembëdhjeta apo e katërmëdhjeta.
- Një fëmijë mund t'i mësojë një të rritur, tri gjëra: të jetë i lumtur pa ndonjë arsye të veçantë, të jetë gjithmonë i zënë me diçka, dhe të di të kërkojë me gjithë forcën atë që dëshiron.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQIJE TË NUMRIT TË KALUAR

R R E S F D E T I
M A M A M M E P K E L
A M I S I M O N I A B O
T O T R E T O R I R A
E N O K D O M A T E L O
R M A R T I R E T E T O
I T A R A O I L A R E R O
A N M A D M A L I A
E N T E V I E A P I R
T E R R I T O R I A L E M

FJALËKRYQI (1)

K L A S A S P A R T A K U
K A R R I E R A A R T
M E R C E N A R A R O
G J A H U N I N J A O
L E T E T O P A N D E
F I A T M S B R O T A
R M R S A M O T E R O
O B E R O N M J A
N I N A M A T H A U
T A S T I R O I D E T
I N T E R I M M K E N

FJALËKRYQI (2)

